

Kuvendi

Qarku Dibër:

Arbjan Mazniku:

Atëherë, të nderuar anëtarë të komisionit, jemi në mbledhjen e radhës së komisionit me dëgjesën për 3 qarqet tjera. Sot do kemi qarkun e Dibrës, më pas qarkun e Vlorës dhe më pas qarkun e Tiranës.

Kemi të katër kryetarët e qarkut Dibër prezent. Dua t'ju falënderoj për pjesëmarrjen, dua t'ju falënderoj gjithashtu edhe anëtarët e komisionit. Për të shpjeguar publikut që na ndjek, por edhe kryetarëve, dëgjesat bëhen në kuadër të komisionit të posaçëm parlamentar për reformat administrative territoriale. Objektivi ynë është të dëgjojmë nga ana juaj problemet, gjërat që kanë funksionuar mirë ose jo mirë në mënyrën se si po operojnë bashkitë, kryesisht në tre kolona kryesore. Kolona e parë lidhet me çështjen e kompetencave. Jemi interesuar të dëgjojmë çfarë ka funksionuar dhe çfarë nuk ka funksionuar në mënyrën se si ju operoni kompetencat tuaja, kur ato funksionojnë, kur ato kanë diçka që s'shkojnë, a i keni mjetet e duhura, qofshin këto financiare, njerëzore, për t'i ushtruar siç duhet kompetencat që bashkitë kanë. Së dyti, në çështje me kolona e dytë lidhet me financat vendore, lidhet në mënyrë të posaçme me mundësitë financiare që bashkitë kanë, qofshin këto nga targat e veta, qofshin ato nga të ardhurat qendrore, mënyrën se funksionon granti, problemet që bashkitë hasin në këtë çështje dhe çfarë mund të rregullohet dhe përmirësohet në këtë kuadër. Së treti, ka të bëjë me territorin, madhësia e bashkisë dhe territori i qeverisë, dhe mekanizmi i qeverisjes është ngushtësisht i lidhur me dy kolonat e mëparshme dhe krijojnë atë që është tërësia e të tre elementëve që lidhin qeverisjen vendore. Është shumë e rëndësishme t'ju shpjegojmë që ky nuk është një komision hetimor, jeni këtu për të dëgjuar, për të dhënë mendimin tuaj siç e mendoni. Anëtarët e komisionit bëjnë pyetjet e tyre dhe më pas secili prej jush ka kohën për t'u përgjigjur për këto pyetje në mënyrën më të mirë të mundshme. Nëse për disa pyetje nuk e dispononi sot informacionin respektiv, ne në zbardhje do të gjejmë pyetjet që nuk kanë marrë përgjigje dhe do t'ia nisim ato sërish në mënyrë shkresore, në mënyrë që t'i marrim këto përgjigje të shkruara eventualisht nga ju kur është diçka që kërkon informacion më të detajuar që sot mund të mos e dispononi. Nga pikëvështrimi i procesit, ne synojmë që kemi vënë dhe një orë në mënyrë që të sigurohemi që në kohën e lënë, që është rreth dy orë për gjithë qarkun, të kemi mundësi të bëjmë maksimumin e pyetjeve, të marrim maksimumin e mundshëm të përgjigjeve. Do ju lutesha që edhe anëtarëve të komisionit që t'i mbajmë pyetjet e përmbledhura për sa është e mundur, dhe gjithashtu ju kërkoj që ju të jeni të përqendruar në pyetjet që bëhen dhe në ato çështje që komisioni ka interes dhe për sa është e mundur t'i mbaheni të përmbledhur përgjigjeve. Duke falënderuar sërish për kohën dhe angazhimin, besoj se mund të fillojmë me mbledhjen. Zoti Boçi.

Luçiano Boçi:

Të nderuar anëtarë të komisionit, nderuar kryetarë të bashkive të qarkut Dibër, mirë se keni ardhur në këtë dëgjes, e cila vjen pas dëgjesës që kemi bërë publike në qarkun tuaj, ku kemi marrë opinionet në fakt të qytetarëve shumë shqetësuese në raport me mënyrën si funksionon pushteti lokal atje, dhe si funksionojnë shërbimet, si performojnë bashkitë, sikurse kemi marrë edhe opinionin e administratës tuaj, drejtorëve, drejtuesve, njësave vendore, duke munguar pikërisht opinionin e drejtpërdrejtë të juaj, për të cilin ne ju kemi thirrur sot në komision. Është shumë e rëndësishme që ju të jepni opinionin tuaj, jo duke qenë halka ndërmjetëse, por duke qenë një ndër hallkat kryesore të funksionimit të bashkisë dhe të mënyrës si ofrohen shërbimet. Po, nuk është komision hetimor, por gjithashtu nuk jemi këtu për të dëgjuar shumë lavde administrative, na i kurseni ato. Nuk është komision dëshirash, sepse unë e di shumë mirë që çdo kryetar bashkie, kur merr detyrën, patjetër ka angazhimin maksimal që ta realizojë mirë detyrën e tij, dhe këtu jemi për të gjykuar mundësitë që keni ju. Këto i gjykojmë. Në fakt, edhe prandaj duam këtë komunikim, i cili duhet të jetë pak a shumë i vërtetë dhe i sigurtë. Këto dy fjalë janë shumë të vështira, se mbartin konotacion, vetë nuk e kanë në kuptimin e vet, konotacion politik brenda. Shumë e vështirë për një drejtues që ka zhgunë apo kostum politik të shprehet për probleme, për çështje të ndryshme, vështirësi që hasin në kryerjen e detyrës së tyre. Ne e duam një gjë të tillë, ne e duam sepse duam të bashkëpunojmë. E duan dhe qytetarët në raport me mënyrën si funksionon ju. Sa i realizoni funksionet që jua tashon ligji, sa kompetenca keni dhe sa mund t'i ushtroni ato kompetenca, varësisht edhe elementëve financiarë që kanë bashkitë tuaja. Dhe si ju ofroni shërbimin, sa përfaqësohen qytetarët në territorin tuaj brenda institucioneve tuaja. Dhe duke konsideruar që Dibra hyn ndër qarqet më malore, unë gjykoj që këtu specifikat janë më të mëdha, vështirësitë janë më të mëdha, edhe mundësitë tuaja janë më të vogla në raport me një bashki tjetër që ka favore të ndryshme që vijnë për shkak të territorit, për shkak të elementëve të tjerë, të pasjes së një aktiviteti ekonomik i cili e ndihmon bashkinë në mënyrën se si ajo mbledh të ardhurat dhe në mënyrën se si ajo performon. Pra, të mos dalim tek ajo se ç'është bërë në sajë të punës suaj, sepse nuk ju gjykon publiku për këtë. Sot, duke ju dëgjuar, publiku ju gjykon atje tek merr shërbimin. Sot, vërtetë jemi për të thënë çfarë shqetësimesh keni. Në qoftë se ju e nisni përgjigjet, i nisni përgjigjet tuaja me këtë, mbas pyetjeve që do ju bëjnë deputetët, atëherë ky komision funksionon, merr ato shqetësime reale, konkrete, të cilat do jenë pastaj në punën e tij, në objektin e punës së tij dhe në fund në konkludimet e tij. E thashë dhe e bëra këtë parashtrim, sepse edhe në dëgjesat e tjera kemi dëgjuar shumë lavde, është bërë kjo që s'do bëhesh për 30 vite, dikush na e ka bërë një punë që s'do bëhesh për 500 vite, se kishe kalkulator personal apo ndonjë program inteligjence artificiale krejt personale, të pashfaqur ende në publik. Nuk i duam këto gjëra. Ne duam gjërat që ju s'mund t'i bëni dot, që ligji jua jep dhe ju nuk keni mundësi. Që nuk keni mundësi t'i shërbeni qytetarit që është shumë kilometra larg, që nuk keni mundësi t'i ruani mbylljen e shkollës apo kufizimin e shërbimit shëndetësor, sikurse dhe shumë kufizime të shërbimeve të tjera. Në qoftë se ecim në këtë ritëm dhe e shohim këtë dëgjesë në këtë këndvështrim, ajo do jetë e frutshme dhe ne do jemi të kënaqur me përgjigjet tuaja në kuptimin e punës së përbashkët që duam të realizojmë. Të jeni të bindur, jemi në reformë se gjërat nuk shkojnë. Nuk jemi këtu për të thënë që sa bukur e kemi bërë 2014-n në raport me 2005-ën, fare. Ne duam problematikat që keni ju post 2014-s dhe 2015-s. Do ju

dëgjojmë me shumë kënaqësi. Faleminderit dhe kalojmë tek pyetjet, në qoftë se ka dikush. Zoti Mziu, po, fjala për ju.

Xhelal Mziu:

Faleminderit. Unë do të tentoj që të ngre disa çështje të cilat kanë të bëjnë kryesisht me funksionimin e pushtetit vendor dhe pavarësisht pyetjeve që do bëj, do doja një opinion, sepse siç e thanë dhe bashkëkryetarët, qëllimi kryesor nuk është për të bërë hetuesi ndaj jush, por qëllimi kryesor është për të përfituar një reformë territoriale administrative që të jetë më afër vendeve të Bashkimit Evropian e për pasojë të ketë mundësi për të bërë rregullimet e nevojshme, të cilët në finale duhet të kenë vetëm një qëllim: për t'i shërbyer qytetarit, për të qenë sa më afër qytetarit dhe për të luajtur gjithë rolin që i takon pushtetit vendor në raport dhe me standardet e vendeve të Bashkimit Evropian. Kështu që në këtë kontekst do të doja përgjigje të cilat të shkojnë në të mirë pa i adresuar, po themi, politikisht. Po e filloj nga një nga kauzat kryesore që ka qenë në vitin 2014 kur u bë reforma territoriale, që ka të bëjë kryesisht me kadastrën urbane dhe ishte vërtetë shumë e rëndësishme dhe unë, duke qenë si një ish-kryetar bashkie, e konsideronim një shtyllë të rëndësishme të funksionimit të pushtetit vendor, kadastrën urbane, kompetencën për t'ia dhënë pushtetit vendor dhe natyrisht edhe të ardhurat që do të krijohen, sepse sot Shqipëria është e fundit në rajon dhe në botë. Në botë nuk e di, por në raport të paktën me Evropën dhe me rajonin, përse i përket mbledhshmërisë së taksës së pasurisë dhe jo pak humbje në këtë drejtim ka dhe pushteti vendor. Ajo se çfarë u tha atëherë ishte që kadastra urbane do t'i kalonte pushtetit vendor. Që nga ajo ditë dhe deri më sot, kadastra urbane nuk i ka kaluar pushtetit vendor. Pra, nuk ka një zyrë kadastrë, nuk ka zyrë kadastrë as në Klos, as në Bulqiz, as madje as në qendrën e qarkut në Dibër, pra tek bashkitë. E për pasojë ka sjellur, po themi, efekte negative, madje përtej kësaj, kadastra urbane është centralizuar tashmë, është larguar dhe më shumë sesa ishte më përpara dhe madje e ka vendosur pushtetin vendor në një situatë jo normale. Në qoftë se ju donit të ndërtonit një investim publik, duhet t'i drejtonit Ministrisë së Ekonomisë, Ministrisë së Financave, për të ndërtuar, pavarësisht sa është pronë shtetërore. Dhe pyetja ime është: ju jeni dakord që si vendet e tjera, kadastra urbane të jetë te bashkitë? Së dyti, të bëhet, po themi, fiskalizimi i tyre, sepse jo pak të ardhura krijohen nga kjo kompetencë dhe për të parandaluar atë që është më kryesorja, konfliktin. Në të katër bashkitë, nga informacionet që unë kam, ka prona me qindra apo me mijëra ndoshta hektarë, të cilët nuk kanë një akt pronësie. E duke mos pasur një akt pronësie, krijon konflikt, nuk krijon të ardhura për bashkinë. Pra, kjo ishte konteksti i pyetjes në lidhje me këtë çështje. Së dyti, një çështje tjetër shumë e rëndësishme, sepse decentralizimi, pavarësia janë elementë shumë të rëndësishëm për pushtetin vendor. Është hequr taksë biznesit të vogël dhe për pasojë ka krijuar një deficit të rëndësishëm në buxhetin vjetor të bashkive. Nuk jam kundër politikës qendrore që bën qeveria. Pra, qeveria e ka të drejtën e saj për ta hequr, po themi, një taksë të caktuar, por duhet të heqë taksë të cilat shkonin te pushteti qendror, jo te pushteti vendor. Por edhe nëse e ka bërë këtë dhe pa pëlqimin tuaj, vendet e tjera të rajonit kur kanë bërë politika të tilla, i kanë kompensuar dhe pyetja ime është: jeni kompensuar ju me këtë dëm të shkaktuar nga heqja e taksës së biznesit të vogël, që i mbledhin bashkitë, që ka ndikuar ndjeshëm, po themi, në aftësinë paguese tuaj? Një tjetër

element: janë deleguar disa kompetenca, madje disa i kalojnë në 38 apo 40, unë mbaj mend nja 7 kompetenca që kaluan në vitin 2015 dhe duartrokitëm në atë kohë, se do të kishim kompetenca, do të kishte mbështetje financiare, etj. Por mbaj mend që një ndër këto kompetenca ishte ujësjellësi. Kaloi madje në 100% te pushteti vendor, histori suksesi. Pastaj filloi ndërhyrja e qeverisë, duke bërë rajonalizimin e tyre nga 58 ujësjellësa në 15 dhe tashmë po i kthen kombëtare, madje duke ju hequr dhe përqindjen. Dhe kur ndodh rajonalizimi, normalisht ulet kostoja. Në të katër bashkitë që ju drejtoni, kur ndodhi rajonalizimi, u rrit tarifa, u rrit numri i punonjësve dhe për pasojë nuk u konvertua në rritje shërbimi. Dhe pyetja ime ishte: jeni më mirë kur vetë bashkia, sepse nuk ka dhe një furnizim uji të centralizuar, po të katër bashkitë kanë burimet të veta, ishte më mirë kur menaxhohej nga vetë ju apo tani e centralizuar me një drejtori në Bulqiz dhe që ka dhënë këto efekte: rritje tarife, rritje fuqie punëtore, në të kundërt të ekonomisë së shkallës. Një tjetër kompetencë ose disa nga kompetencat e tjera kanë qenë zjarrfikësit, kullimi, mirëmbajtja e rrugëve, pyjet dhe disa kompetenca të tjera, të cilët shoqërimi i financave në këto kompetenca ka qenë i pamjaftueshëm, të paktën në informacionet që unë kam dhe disponohen nga Ministria e Financave. Pyetja ime është: a kanë mjaftuar ato delegim fondesh për këto kompetenca tek ju? Sepse shumica e bashkive, edhe kur ka një zjarr, edhe kur ka, po themi, përmytje apo edhe kur ka nevojë për vaditje, nuk mjaftojnë dhe detyrohen bashkitë për të shkuar për të marrë paratë që mund t'i adresonin tjetërkund për t'i përdorur. Dhe në këtë kontekst ka të bëjë edhe njëherë: jeni dakord me aq sasi parash që ato adresojnë? Aq më tepër ka bashki të cilët kanë pyje pafund dhe mund të kenë ndoshta një apo dy persona dhe përtej kësaj nuk kanë të drejtë për të krijuar dhe të ardhura, bie fjala për pyjet apo për të tjerë elementë të cilët shpenzojnë. Një tjetër element shumë i rëndësishëm që do të doja po prapë nga ju ka të bëjë me taksat kombëtare. Nuk e di se sa rend minerare merr nga minierat Bashkia e Bulqizës apo Bashkia e Klosit apo Bashkia e Matit në këtë drejtim dhe a jeni të kënaqur me atë rend? Të gjithë njerëzit duartrokasini për kontributin që japin minierat për buxhetin e shtetit dhe e konsiderojnë Bulqizën, Klosin si një pari si i dytë, por në fakt ajo që e mban qytetin është bashkia. Kush është vlera që ju merrni në lidhje me këtë rend? Një tjetër element janë taksat kombëtare. Taksa kombëtare që kanë të bëjnë kryesisht me të ardhurat. Merrni ju taksë kombëtare për tatimin? Mbi pagën etj., merrni? Apo jo? Vendet e tjera rajonit e kanë. Një tjetër element ka të bëjë me ndërhyrjen në kompetencat ose dublim të kompetencash, më saktë. Keni IMT-të, është IKMT-ja, është Policia e Shtetit, tani është dhe AZHT-ja, por se besoj AZHT-ja tash trimë funksionin deri tek ju. Ndiheni mirë kur tek një ndërtim shkojnë 3-4 struktura shtetërore, kur atë kompetencë mund ta luajë vetë pushteti vendor nëpërmjet IMT-së që ka, siç e kanë edhe vendet e tjera rajoni. Nëse nuk e përmbushni apo një person nuk e përmbush dhe nuk e zbaton ligjin, është ligji që operon ndaj atij personi. Përkundrazi, kur shkojnë 4 institucione, e vendosin në situatë kritike, po themi, atë personin, se ndoshta mund të përkthehet dhe në 7 gjoba informale ndaj atij personi. Një tjetër çështje: 4 bashki që ju drejtoni kanë të ardhura tulta, poshtë mesatares, dhe kjo në fakt unë nuk e konsideroj për shkak të paftësisë suaj, por për shkak të resurseve që ka ajo zonë dhe a keni marrë, po themi, financim ekstra, siç e kanë vendet e tjera të rajonit, ku aplikohet taksë balancimi? Kur të ardhurat e në rang kombëtar janë poshtë mesatares, të gjitha vendet e rajonit dhe të Bashkimit Evropian aplikojnë një taksë balancimi që të

mos ndihen inferior, po themi, qytetarët e qarkut të Dibrës, po themi, në raport me një qark tjetër që ka shumë të ardhura për shkak të biznesit apo për shkak të bregdetit apo mjaft faktorë të tjerë. Pra, është aplikuar kjo taksë balancimi? A ishit dakord ju që të kishte një taksë të tillë balancimi? Një tjetër element: 1% kanë qenë taksa, ka qenë transfertë e pakuruar në fillim të vitit, edhe atëherë. Vazhdon që të jetë 1% sot, pavarësisht se buxheti i shtetit, po themi, është dyfishuar. Jeni dakord me atë 1%? Ju kujtoj që vendet e rajonit e kanë diku te 5-6%, ne shkojmë diku, përveç 1% që marrin disa nga këto kostot e delegimit të kompetencave, marrim diku te 3%, pra dy herë më pak sesa rajoni, shumë herë më pak sesa Bashkimi Evropian. Pra, pyetja ime është: ju mjaftojnë? Një tjetër element po marr vetëm rastin e Dibrës. Ka 15 bashki, kështu njësitë vendore ndjesë, ka ish-komuna 14 sot dhe një bashki 15. Është disproporcionale, është bashkia që ka më shumë njësitë vendore, është më shumë sesa dy herë mbi mesataren e Shqipërisë dhe në këtë aspekt ka ndikuar drejtpërsëdrejti në shpopullimin e Dibrës. Dhe jam i sigurt që z. Spahiu e dinë situatën që ka krijuar, sepse një qytetar që të vijë nga Reçi i duhet të paktën nja 40 km për të ardhur, dikush që vjen nga Zalldardha po aq, pak më pak, dikush që vjen nga Selishta, apo nëse merremi me Trebishtin për të shkuar në Bulqiz që i duhen nja 46 km, apo Macukulli për të shkuar në Burrel, pra çfarë do të thotë që jo vetëm e ka larguar, po themi, shërbimin ndaj qytetarëve, por përkundrazi ka krijuar një kosto ekstra për qytetarët. A ndiheni, po themi, të barabartë në trajtimin e qytetarëve, sepse një qytetar që është brenda qytetit e ka pothuajse koston zero të shërbimit, por një qytetar që vjen nga këto zona që unë thashë që duhet të paguajë për të ardhur atje, madje e-Albania nuk punon. Në shumicën e rasteve, por edhe kur punon nuk ka internet, ju kujtoj në këto zona është e vështirë për të punuar celular, jo për të punuar e-Albania, është një kosto shtesë dhe në këtë kontekst, duke ju referuar dhe mesatarës së vendeve të Bashkimit Evropian që kanë të paktën 4 apo 5 herë më pak banorë për njësitë vendore, a nuk do të ishte më oportune? Po themi që Dibra të kishte bashki ekstra, siç mund të ishte Maqellara për shembull, apo siç mund të ishte Kastrioti, apo siç mund të ishte Arasi me pjesën tjetër fundore me Lurën apo me Zalldardhën apo me Reçin, e njëjta gjë mund të ndodhte, po themi, me Bulqizën. Ne kemi bërë bashki, siç është Pushtets, me shumë pak banorë, ndërkohë kemi Golobordën me 3 ish-komuna, madje njëherë ia kanë kaluar Librazhdit dhe nuk është bashki, edhe për shkak të kombësisë së tyre, ndoshta duhet të ishte bashkia aq më tepër, edhe për shkak të distancës edhe mbështetjes që duhet t'ju jepej, apo që ato të përfitonin. Dhe pyetja ime është: a ndiheni rehat me këtë lloj ndarje? Doni që të bëhet më me shumë njësitë vendore për t'i ardhur më afër qytetarit, apo doni që ta centralizoni? Për të qenë po prapë më konkret: ishit dakord me këto, do ishit dakord me këto hotspot-e ose këto bashki të reja për t'i afruar më shumë shërbimin qytetarëve, apo për të mbajtur këtë bashki, apo bie fjala për t'u bashkuar Bulqiza me Dibrën, apo për t'u bashkuar Klosi me Burrelin? Unë nuk po e zgjas më tej, do të doja që qasja juaj të kishte të bënte fiks me këtë çështje, të cilët nuk ka të bëjë me kapitalizim politik, por ka të bëjë me një çështje shumë të rëndësishme për qytetarët, për të bllokuar shpopullimin apo rrënimin e bujqësisë, apo mbylljen e shkollave. Dhe një gjë tjetër: është kaluar kompetenca e mirëmbajtjes së shkollave, e arsimit parashkollor, e qendrave shëndetësore. A mjaftojnë fondet? Se kur dal në të gjitha zonat rurale, jo vetëm në Dibër, kjo ndodh dhe në gjithë Shqipërinë, natyrisht një kryetar bashkie do t'i shërbejë më shumë qendrës së qytetit sesa

periferisë e për pasojë po të shkosh në të katër bashkitë tuaja, por natyrisht dhe në pjesën tjetër, por sidomos qarku i Dibrës është dhe qarku më i varfër, shef shkolla pa rrethim, pa ujë të pijshëm, pa banjo ose me banjo të prishme, etj., dhe nuk besoj që është një dëshirë e juaja për t'i lënë në këtë gjendje, por pamjaftueshmëria financiare që ju keni për të mbajtur këto kompetenca ekstra, por që nuk janë shoqëruar me financa. Faleminderit!

Arbjan Mazniku:

Faleminderit zoti Mziu! Kryetarët, megjithëse pyetjet ishin të shumta dhe me radhë, secili prej kryetarëve besojmë të marrë i kond përgjigjet atyre pyetjeve që janë relevante për bashkitë respektive. Zonja Mjeshtri!

Festime Mjeshtri:

Të nderuar anëtarë të Komisionit, jam Festime Mjeshtri, kryetare e Bashkisë së Bulqisë që nga viti 2023. Për Bashkinë e Bulqisë, reforma territoriale e vitit 2014 ka sjellë ndikime pozitive dhe ka krijuar më shumë peshë administrative, ekonomike dhe zhvillimore. Sot Bashkia përfshin 8 njësitë administrative dhe 63 fshatra, duke krijuar mundësi më të mëdha në investimin dhe koordinimin e të gjithë punëve. Dëgjova me vëmendje të gjithë pyetjet e shokut Mziu për pjesën e kadastrës, ne prandaj jemi këtu sot për të rishikuar dhe për të dhënë sugjerimet tona për reformën territoriale, që shërbimet të ofrohen më mirë, që Bashkia të ketë kompetenca më shumë, siç është pjesa e kadastrës, pjesa e arsimit parauniversitar, pjesa e njësive vendore të qendrave shëndetësore, që akoma shërbimet të ofrohen më shumë. Dëgjova për pjesën e flas për Bashkinë e Bulqisë, nga Trebishti te Vishnja e Bulqisë janë 35 km rrugë dhe ne si Bashki, para vitit 2014, ato zona kanë qenë komplet të harruara, mbas vitit 2014 janë shtuar investimet, ka infrastrukturë dhe akoma më shumë po punojmë çdo ditë të jemi në shërbim të qytetarëve. Normalisht që sfida jonë është shpërndarja e madhe e territorit, por duke qenë shpërndarja e madhe e territorit, ne kemi ofruar më shumë shërbime, normal që është rritur numri i punonjësve për arsye të shërbimeve, sepse ka shërbime më shumë. Vlerësojmë edhe fazën përse i përket prioritetëve: forcimi i kapaciteteve. Ne kemi forcuar kapacitetet tona me qëllim që t'u ofrohet shërbimi të gjithë qytetarëve. Ne kemi 63 fshatra dhe asnjë fshat nuk është i braktisur, sepse ofrohen shërbime më mirë. Sa për pjesën e taksës, taksës së vogël, që ka qenë një nga politikat e qeverisë, kjo nuk na ndikon fare në buxhet, është në të mirë për të ndihmuar komunitetin ku ne jetojmë. Të flasësh për Bulqizën apo për qarkun Dibër, tashmë investimet dihen dhe investimet janë madhore dhe nuk mund të themi që qarku Dibër është një ndër qarqet më të varfra. Të ardhurat, sepse do t'i përgjigjemi shkurt pyetjeve, të ardhurat nga minierat, dihet që Bulqiza është një qytet industrial dhe 20-25% e të ardhurave kalojnë buxhetit të Bashkisë. 400 milionë lekë. Tani unë kam flas me shifra. Ne këtu funksionojmë normalisht, prandaj jemi këtu, që funksionet na kalojnë më shumë bashkive, që ne të jemi më kompetentë për të bërë punët tona akoma më mirë. Po. Mbaruam. Po, po.

Arbjan Mazniku:

Dikush nga kryetarët e tjerë? Zoti Spahiu?

Rrahim Spahiu:

Atëherë, Rrahim Spahiu, kryetar bashkie në Bashkinë e Dibrës nga viti 2022. Me thënë të drejtën, shqetësimi im nuk është nëse do bashkohen bashki apo do ndahet Bashkia e Dibrës, por shqetësimi im është për kompetencat që ka Bashkia dhe sqarimi më i mirë i këtyre kompetencave që ka Bashkia e Dibrës. Është e vërtetë se Dibra është një bashki, është ndër bashkitë me shtrirjen territoriale më të madhe, e treta më duket të vjen nga në Shqipëri, rreth 1000 km². Është e vërtetë që Bashkia e Dibrës është një vend malor, por kjo nuk do të thotë që në këtë bashki, pas ndarjes territoriale të vitit 2014, nuk u ka shkuar shërbimi banorëve të zonave. E them këtë për arsye se nuk jemi sot, në 2026-n nuk jemi në atë fazën e vitit 2014, kur është bërë reforma territoriale, se në qoftë se në 2014-n në Lurë duhet të shkoje për 4 orë, sot shkohet për 40 minuta në Lurë. Po kështu po punohet që të shkohet për kaq, edhe për 30 minuta edhe në Reç, edhe në Selisht. Jemi në një situatë tjetër, ku investimet që janë bërë në këtë bashki bëjnë që shërbimet të shkojnë në zonën më të largët të Bashkisë së Dibrës. Pra, në qoftë se deri sot nuk ka shkuar në Lurë makina e pastrimit, sot në Lurë shkon makina e pastrimit edhe Lura që ka qenë një nga zonat më të largëta të Dibrës. Është e vërtetë që bashkitë kanë nevojë për më shumë kompetenca, duke filluar nga problemet që hasen me zonat e mbrojtura, nga problemi që shtrojnë deputeti për problemet me hipotekat, nga problemi për arsimin parashkollor, se Bashkia merret me të gjitha ato dhe në fund për sistemimin e mësuesve në punët e arsimit parashkollor merret arsimi edhe jo vetëm arsimi në Dibër, por duhet të fillojë, vijë kërkesat e Bashkisë, shkon te zyra arsimore në Peshkopi, pastaj kalohet në Durrës, pastaj nuk e di a kalohet në Ministri, por është një diçka që i rraskapit njerëzit. Pra, edhe kjo mund të shikohet. Por duke iu përmbajtur pyetjeve që bëri deputeti i Dibrës, zoti Mziu, është e vërtetë që është më mirë që hipoteka të kalojë te Bashkia. Mbledh edhe më shumë të ardhura, mbase u përgjigjet më mirë qytetarëve se gjithë qytetarët përplasen te Bashkia, por kjo nuk do të thotë që nuk ka funksionuar kështu si është. Hipoteka e Dibrës ka marrëveshje me Bashkinë, Bashkia ka një zyrë pronash, kombinojnë të dyja edhe nuk ka pasur një ngërç edhe një problem në lidhje me regjistrimin e pronave. Ose për problemin e të ardhurave, që bëhej fjalë për taksat e biznesit të vogël. Unë kam qenë drejtor tatimesh në Dibër në kohën kur taksat kalonin nga tatimet në Bashki. E di sa janë taksat e biznesit të vogël, tatim fitimit dhe taksat e biznesit të vogël në Bashkinë e Dibrës, që mbledhen, që mbledhin tatimet? Janë 1 milionë dollarë. Të gjitha. Ndërkohë, kur transfertat që vijin nga qeveria janë shumë më shumë se kaq. Janë bashki që nuk gjenerojnë shumë taksa nga biznesi i vogël. Tjetër. Edhe problemin që thashë për zonat e mbrojtura, është e vërtetë që mbase do të duhet të shihet një ndërthurje për zonat e mbrojtura, pasi zonat e mbrojtura, ajo drejtori janë përgjegjëse për gjithë zonat e mbrojtura, ndërkohë ku gjithë shërbimet i bën Bashkia. Bie zjarr në zonat e mbrojtura, bie zjarr në Lurë edhe të gjitha këto shërbime i bën Bashkia, me zjarrfikëse, me shpenzime, me të gjitha. Kështu që këtu mendoj që mbase mund të shihet diçka që të kenë më shumë kompetencë Bashkitë për sa u përket edhe zonave të mbrojtura. Gjithsesi, problemet tjera, Bashkitë kanë nevojë për më shumë financa, s'diskutohet, sa më shumë financa të ketë Bashkia, por ama këto financa kanë ardhur gjithmonë rritje në Bashki. Edhe unë po fol për katër vitet e fundit që jam unë, që jam bërë një transformim total i Bashkisë së Dibrës, në shkolla, në kopshte,

në rrugë, në ujë të pijshëm, në ujë të vaditës. Ndërsa në lidhje me ujësjellësin, është e vërtetë që gjithë përplasjet e Bashkia për problemet e ujit, por Bashkia vazhdon të jetë aksionere, kështu që i ka 29% të jetë aksionere. Me këtë formë, mbase mbase ka funksionuar më mirë, për arsye se më mirë, më mirë në kuptimin që ka pasur më shumë investime. Ka pasur më shumë investime nga qeveria. Ka qenë rasti që kam qenë edhe drejtor ujësjellësi dikur edhe ujësjellësi me të ardhurat e veta nuk është në gjendje të bëjë investime. Qoftë edhe ujësjellësat e zonave të Tiranës apo zonave tjera, nuk ka mundësi që të bëjë investime. Investime po s'bëri qeveria në ujësjellësa, nuk është mundësia që të bëjnë Bashkitë. Pastaj ne Bashkitë i kaluam vetë ato ujësjellësat me këshill bashkiak, kështu që nuk kemi ku ta qajmë këtë, ta qajmë te vetja. Gjithsesi, për gjëra tjera në vazhdim.

Arbjan Mazniku:

Zonja Kola.

Valbona Kola:

Të nderuar bashkëkryetar, të nderuar anëtarë të Komisionit të Reformës Territoriale, shumë faleminderit që na bëtë pjesë sot të këtij takimi, që është shumë i rëndësishëm për një proces shumë të rëndësishëm, që është reforma territoriale dhe që ka të bëjë drejtpërdrejt me shërbimin ndaj qytetarëve. Ashtu siç e thanë, në fakt sot përballë qytetarëve, si unë dhe kolegët e mi dhe të gjithë ju, duhet të jemi të zhveshur nga kostumi politik. Është shumë e rëndësishme që t'i japim shërbimet çdokush kush ka marrë detyrën si kryetar bashkie, përballë qytetarëve është i barabartë me të gjithë, ashtu si çdo qytetar ka, është përballë ligjit është i njëjtë, ashtu ka dhe të drejta të barabarta. Për sa i përket reformës territoriale, reforma territoriale e vitit 2014 ka sjellë ndryshime, në fakt, në përsa i përket funksionalitetit të shërbimeve. Shërbimet kanë qenë më cilësore, por edhe të administratës publike, duke e konsoliduar atë më shumë. Është desha të bëj një rezume pak për Bashkinë e Kllosit, për gjithë ato që nuk e kanë shëtitur si territor. Unë vij nga fusha e mjekësisë, për 33 vite kam shërbyer në fushën e mjekësisë, duke i shërbyer qytetarëve dhe sot jam prej tre vitesh kryetare bashkie, po prapë në shërbim të qytetarëve, në një dimension shumë më të gjerë. Për sa i përket pyetjes së kadastrës urbane, në fakt duhet të jetë kompetencë e Bashkisë. Bashkia e Kllosit është një territor në zhvillim sot, një bashki në zhvillim, falë rrugës së Arbrit. Kërkesat janë të mëdha për ndërtime, për zhvillim të bujtinave, agroturizmin. Ka kërkesa edhe nga fshatrat që kanë qenë të braktisura në kohët e përparshme për shkak të mungesës së ujit dhe sot që janë bërë me ujësjellës dhe me ujë të pijshëm, kërkojnë që të vijnë të investojnë në pronat e tyre. Ndaj mendoj që ky shërbim në Bashkinë e Kllosit duhet të jetë edhe për të regjistruar pasuritë dhe taksa e pasurisë është një burim për financën e Bashkisë për të arritur këtë. Dhe mendoj që regjistrimi i pronave dhe rishikimi i planit vendor, që ne na ka lindur nevoja për ta bërë rishikimin e planit vendor për shkak të kërkesave për të zhvilluar dhe rruga e Arbrit i jep një tjetër orientim rishikimit të planit vendor dhe zhvillimit. Besoj që do t'i japi një frymë tjetër, një oksigjen Bashkisë së Kllosit për sa i përket ndërtimeve. Kështu që mendoj sot jepet online ky shërbim, por duhet të jetë në Bashki, duhet të jepet në Bashki si shërbim.

Për sa i përket decentralizimit, në fakt mendoj që reforma territoriale e 2014-s solli decentralizim, por solli shumë shërbime në Bashki, siç është furnizimi me ujë të pijshëm, administrimi dhe mirëmbajtja e sistemit të vaditjes, arsimit parauniversitar, pyjet, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrugëve rurale dhe funksione të tjera, por që përveç shërbimit të zjarrfikësit, që ka një buxhet të mjaftueshëm për shërbimet, të tjerat nuk e kanë, të gjithë funksionet e tjera nuk përballohen me atë çfarë nga transfertat e kushtëzuar. Ndërsa shërbimi në mirëmbajtjen e rrugëve, Bashkia e Kllosit nuk merr fare transfertë, nuk ka transfertë, nuk ka buxhet për këtë, por me vështirësi, mbase me sforco, Bashkia e Kllosit mundohet që t'i japë këto shërbime në nivele që i duhen qytetarëve. Për sa i përket ujësjellësit, në fakt, ujësjellësi si shoqëri që kaloi me vendim këshilli, unë kam opinionet e qytetarëve sot që vijnë dhe ankohen në Bashki. Kryetare, më përpara kur ishte ish-kryetari, nuk kemi qëndruar kaq gjatë pa ujë. Në fakt, për sa i përket investimeve të mëdhaja, sepse në 2016 në Bashkinë e Kllosit furnizoheshin me ujë vetëm 20% të banorëve, ndërsa sot janë bërë me ujë që e marrin me ujësjellës, me standarde, rreth 90-95% të banorëve furnizohen me ujë të pijshëm. Dhe këto investime të mëdhaja që u që vetëm për këto tre-katër vitet e fundit janë investuar me miliona euro, nuk bëheshin dot me fuqinë e Bashkisë, por nga qeveria. Ndërsa mirëmbajtja e ujësjellësit, të them të drejtën, ka sjellë shumë problematika, ka vonesa. Ne qytetarët njohin kryetarin e Bashkisë dhe trokasin në fillim tek kryetari i Bashkisë për zgjidhjen e problematikave. Ne me shumë sforco, me shumë kosto, jemi përballë qytetarit, atij që na ka besuar dhe na ka votuar, ndaj duhet t'i shërbejmë pa diskutim, sepse nuk mund ta mendojmë kurrë veten pa ujë të pijshëm si një nga elementët bazë jetik. Për sa i përket pyjeve dhe kullota, në fakt, jo të gjithë kompetencat janë. Bashkia nuk e ka mundësinë vetë që ta shfrytëzojë një sipërfaqe. Ne e kishim një sipërfaqe të djegur në plan të bardhë vitin e kaluar, por na u desh kohë që ta miratojmë për ta shfrytëzuar, sepse Bashkia ka nevojë edhe për drasën, edhe për armaturën, edhe për lëndë tjera drusore. Domethënë, që sa të kalbet atje dhe për ta pastruar tek e fundit, që ta rehabilitojmë në një moment tjetër. Duhet më shumë kompetenca, të rregullohet një bazë ligjore ku Bashkitë të kenë fuqinë vetë dhe ta përdorin këtë lëndë drusore pa sërrollatje. Për sa i përket taksës së biznesit të vogël që kryetari i Dibrës, kolegu, foli, ne nuk e kemi arritur. Unë kam vetëm tre vite eksperiencë në Bashkinë e Kllosit, por gjatë bisedave me stafin tim të financës ankohen që kjo taksë, në fakt, i ka sjellë goxha deficit Bashkisë në mbledhjen e të ardhurave. Ne kërkojmë të ardhura, por të ardhurat, themi, i kemi në Bashki, por në fakt një pjesë të ardhurave ne nuk i marrim. Renta minerare, si Bashki që e ka këtë industri, në fakt, industria minerare në Bashkinë e Kllosit mbahet. Bashkia e Kllosit ka një numër të konsiderueshëm që punojnë nëpër miniera, apo në ato kemi dhe hidrocentralet, apo energjinë e gjelbër. Renta minerare në Bashkinë e Kllosit vjen vetëm me 1.6 milionë lekë të reja, domethënë 16 milionë lekë të vjetra. Unë mendoj, edhe nga kolegët dhe këtu kam çekuar diku që të di të vërtetën përse një bashki merr kaq pak, apo një bashki tjetër mund të marrë më shumë. Gjithë problemi qëndron te kshitja në doganë, kur një pjesë e bizneseve e shesin tek, mbase tek një tjetër, dhe ai tjetri që mund të jetë një bashki e tjetër e shet në doganë, dhe taksa shkon për bashkinë që e shet, për personin bën nëse është në Bashkinë e Bulqizës. Më fal, kolege, shkon për Bashkinë e Bulqizës. Unë e kërkoj këtë të rishikohet baza ligjore, po pse mos të përlogaritet që në prodhim, në burim, dhe taksa t'i shkojë tek i zoti? Kjo taksë të

përllogaritet, bën duke nga burimi aty ku prodhohet, që edhe Killosit t'i shkojë taksa që duhet. Dhe këto janë, edhe po them, po nëse dikur, sipas kolegeve të mia, taksa ka qenë 25%, sot është një vlerë jo e papërfillshme. Është e papërfillshme, në fakt, që po qe se e marrim këtë 25% të taksës, edhe taksën vendore, dhe këto janë taksat, të shfrytëzojmë akoma më shumë, edhe taksat e tjera, besoj që Bashkia e Killos në një të ardhme shumë të shkurtër do të jetë bashki që do mirë administrojë dhe do t'i heci, siç e themi ne, në këmbët e veta. Bashkia e Killos është një bashki me territor të madh, por me tipologji, jo si gjithë bashkitë e tjera, por është pothuajse malor. Bashki që shtrihet me një përqindje rreth 12% të banorëve janë në fushë, dhe pjesa tjetër është kodrinore dhe e shtrihet në kodrinë dhe në mal. Pa diskutim që vështirësitë janë këtu për të marrë shërbimet, po qe se kjo bashki është në një territor shumë të vështirë. Unë e them hapur këtu dhe të më, duke i kërkuar ndjesë banorëve të Ketës, të cilët kanë, pavarësisht mënyrës që kanë zgjedhur ato që ta ngrejë problematikën, por unë ju them, u kërkoj dhe ndjesë, sepse nuk kam qenë shumë në kohë dhe aq sa duhet në shërbim të banorëve të Ketës, për mirëmbajtjen e rrugëve, apo edhe në shërbime të tjera, sepse ka vështirësi terreni për të përcjellur makinat në Ketë. Më duhet një ditë vetëm për të vajtur dhe për të ardhur. Kështu që shërbimet janë pak më të vështira në territore malore, ndaj mendoj që ju do të jeni të vëmendshëm në këtë reformë territoriale për të parë dhe tipologjitë e bashkive, sepse misioni ynë është shërbimi ndaj qytetarëve të jetë sa më afër, por dhe sa më cilësor. Për sa i përket transfertave, në fakt, aktualisht jemi një bashki që nuk jemi të pamvarura nga qeveria qendrore. Jemi bashki që jemi totalisht të mvarur, mund të them, nga qeveria qendrore, duke e krahasuar me vitin 2016. Kemi përmirësime si rritje, domethënë, edhe të transferit të kushtëzuar dhe të transferit të pakushtëzuar, por edhe të ardhurave. Në vitin 2016, që unë e kam marrë si referencë, dhe 2026-ën, kemi një rritje prej 57% të transferit të pakushtëzuar. Transferi e kushtëzuar ka një rritje prej 65% dhe të ardhurat në Bashkinë e Killosit, duke u krahasuar me vitin 2016, rriten me 73%. Kërkojmë shumë, domethënë, ne kemi vështirësi të mëdhaja. E kemi diskutuar gjithmonë. Në fillim kishim vështirësi kur mora detyrën edhe për sa i përket burimeve njerëzore, por që investuam shumë në nivelin e pagave, që këto të rinj dhe të reja t'i mbajmë. Dhe unë kam një staf që punoj sot me një grup moshe nga 25, maksimumi 45 vjeç, janë rreth 85% e stafit që qëndruan të punojnë në Bashkinë e Killosit, por edhe të investojnë për vendin e tyre. Kërkoj shumë, domethënë, që mbase bashkitë me më pak të ardhura, që nuk kanë mundësi, mbase edhe ku t'i marrin të ardhurat, duke parë dhe territorin që është shumë i vështirë për të dhënë shërbimet dhe për të qenë më afër qytetarëve, të rishikohet edhe formula e përllogaritjes së transferit të kushtëzuar. Është shumë e rëndësishme që nëse një bashki në bregdet nuk ka ose nuk i përdor të gjithë të ardhurat, ne kemi shumë mungesa dhe jo se s'dimë t'i përdorim ato, jo se s'dimë të kemi prioritetet tona dhe t'i vëmë në zbatim, por që mungesa e të ardhurave bën që nganjëherë kryetari i bashkisë të dalë edhe jashtë pritshmërive të veta, por edhe për realizimin e premtimeve në territor ndaj banorëve. Për sa i përket investimeve, në fakt, në Bashkinë e Killosit, një ndryshim radikal shikoj, sepse unë, duke qenë dhe mjeke, duke e thashë që në fillim, e kam shëtitur gjithë territorin e Bashkisë së Killosë, por edhe anën sociale të çdo familje, pothuajse isha pjesë e çdo familje të Bashkisë së Killosit, e njoh mirë. Them se duhet pak investim dhe duhet parë edhe në këndvështrimin e tipologjisë së bashkisë si bashki malore, dhe ky territor që

është, është i mjaftueshëm edhe me pak mungesa, domethënë, po është i mjaftueshëm për t'u menaxhuar. Besoj që për në një territor më të madh se Bashkia e Killosit do të jetë shumë e vështirë për t'u ardhur në ndihmë banorëve. Shumë faleminderit. Nëse e kam lënë ndonjë pyetje, pa diskutuar, edhe mund të më drejtoheni.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zonja Kola. Zoti Bojni.

Altin Bojni:

Përshëndetje, të nderuar bashkëkryetar, anëtarë të komisionit, deputetë, kryetarë të bashkive. Bashkia e madhe, për sa i përket reformës territoriale të vitit 2014, ka pasur një ndikim të madh për sa i përket rritjeve në investime, ashtu në infrastrukturë, në ujësjellësa. Sot, pastrimi për popullsinë është gati 85%, që do të thotë nuk është diku ka qenë vetëm pjesa e bashkisë së qytetit, por kemi edhe në njësi administrative të tjera, në qendra shëndetësore apo në shkolla. Një përmirësim të madh ka sjellë kjo reformë, qoftë edhe në shërbimet që në çdo cep të bashkisë, për sa i përket pastrimit, apo gjelbërimit, apo dhe pjesës së ndriçimit, strehimit, shërbimit social si për fëmijët me aftësi të kufizuar, apo dhe në moshën e tretë, ku deri dje këto shërbime nuk e ofronin ndoshta për shtatë komunat, ish-komunat që janë bashkangjitur të bashkisë së madhe. Për sa i përket pyetjeve që bëni, zoti deputet, për sa i përket pjesës së pyetjes së parë, për sa i përket kadastrës, po, edhe bashkia, të gjithë problemet edhe hallet shkojnë tek kryetari i bashkisë, tek punonjësit e bashkisë që të marrin një shërbim sa më shpejt, edhe mund të kalojë, por jo që nuk ka funksionuar kadastra e madhit. Edhe kadastra kanë funksionuar, por për shërbime mund të kalojë edhe si kompetencë pjesës së bashkisë. Për sa i përket ujësjellësit, ujësjellësi ka qenë edhe pjesë e bashkisë, por me kalimin është bërë rajonale. Është edhe bashkia pjesë e asamblesë së ujësjellësit, por duke parë investimet që bashkia e madhe ka ofruar kur ka qenë pjesë e bashkisë, i bie që gati 85% e popullsisë sot, 80% e popullsisë sot është në ujë të pijshëm. Qyteti i Burrelit është me ujë 24 orë, falë gjithë këtij investimi që është bërë. Për pjesën e transferteve, që është 1% si Bashkia e Madhit, apo Bashkia e Killosit, e Bulqizës, apo pjesa jonë, varemi edhe te pjesa e transferteve. Mirë do ishte që kjo transferte të ishte ndoshta 2% deri në 5%, që mund të kemi mundësi edhe më shumë që të bëhen më shumë investime në territorin e bashkisë. Për sa i përket pyetjes tjetër, ishte pyetja për biznesin e vogël. Nuk jemi kombësuar drejtpërdrejt, por për sa i përket Ministrisë së Financave, gjithmonë në fund të vitit ose gjatë vitit bën edhe pjesën, edhe financohen edhe pjesa e bashkisë. Tek taksa kombëtare e rendes minerale, Bashkia e Madhe është vetëm me pesë miniera, edhe nuk është se ka një ndikim financiar që mund të ndikojë në të ardhurat tona. Për furnizimin e ujit të pijshëm, atë që e thashë, është më mirë se ndërhyrjet mund të jenë edhe më të shpejta, edhe mund të jetë edhe më afër komunitetit dhe pjesëve të banorëve. Territori jonë është një territor malor, është gati 500 km katrorë. Normalisht që sot, me reformën e re, ne kemi edhe grupe pune, edhe makineri, që në çdo territor mundohemi që t'i kapim sa më shpejt. Infrastruktura për pesë vitet e fundit është gati 50 km sot asfaltim, kështu që e bën vetëm më të aksesueshmen në qendrën e qytetit. Shumë faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Mziu.

Xhelal Mziu:

Po, i dëgjova ato përgjigjet tuaja që dhatë. Një pjesë prej tyre ishin koherente me gjërat që ndodhën. Një pjesë u anashkaluan. Sidoqoftë, është një sfidë për mua, për pushtetin vendor, një sfidë për të patur potencialin e nevojshëm për t'i shërbyer qytetarëve. Një pjesë prej jush e thatë reale, bie fjala, çdo qytetar, edhe kur nuk ke kompetencë, vjen dhe troket te bashkia, sepse atë e ka më afër. Por më e keqja është që ti ke kompetencën dhe nuk e zgjidh. Bie fjala, po marr vetëm Dibrën. Vaditja është kompetencë e bashkisë. Shumë mirë e dini që Dibra sot, duke filluar nga Maqellara, apo nga Melani, apo nga Tomini, apo nga Kastrioti, apo nga Fushalia, janë me mijëra hektarë tokë që nuk vaditen. Dhe absolutisht jam i bindur, nëse ju do të kishit patur financa mjaftueshme për këtë shërbim shumë të rëndësishëm, ose për bujqësinë, që është indikator numër një i punësimit, por dhe i kontributit, do të kishin qenë efektive, sepse ju e dini shumë mirë që ato toka kanë qenë të vaditura. Pra, do të thotë, ekziston mundësia që ato të vaditen. Kështu që kjo është një gjë shumë e rëndësishme, të cilën duhet ngritur zëri për një gjë që është e pamjaftueshme, po themi, financiarisht për t'u bërë nga bashkia. Ose po marr rastin e bashkisë së Madhit. Ka dy çështje. Pothuajse një pjesë e konsiderueshme e tokës është e përmbytur nga hidrocentrali dhe zero lekë merr. A nuk është një drejtë për këtë, po themi, potencial të munguar për të patur një tarifë ose për të patur një financim? Dhe së dyti, Bashkia e Burrelit. Të katër bashkitë, madje Çaku i Dibrës ka dhe një rekord. Ka 20 punësuar për 1.000 banorë. Është pothuajse shifër alarmante. Por nëse është numër nishi për Shqipërinë, është Burreli tetë herë më shumë. Është rritur fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore në këto vite, ose më saktë, për të qenë korrekt, nga viti 2015 deri në vitin 2024, tetë herë më shumë. Normalisht nuk jam kundër rritjes së pagës, madje duhet të rritet edhe më shumë paga, por jam kundër rritjes së numrit të punonjësve, sepse ka qenë një kauzë për të rritur, për të ulur numrin e punonjësve, dhe në fakt sot është dy apo 2.3 herë më shumë është rritur numri i punonjësve. E përshkruar te, po prapë tek Madhi, si ka mundësi që është tetëfishuar, po themi, fondi i pagave dhe indikator kryesor i saj ka qenë numri i të punësuarve, të cilët një pjesë prej tyre nuk e dinë ndoshta kush është vendi i punës, as nuk kanë një karrike, apo një zyrë, apo një kompjuter, apo një vegël pune, por thjesht marrin pagat dhe ndërkohë shumë mirë mund të shkonin në një destinacion tjetër. Kështu që do të doja dhe një opinion, të paktën prej jush dyve, për ta mbyllur pastaj.

Rrahim Spahiu:

Atëherë, po e marr unë fjalën.

Arbjan Mazniku:

Po, lutem.

Rrahim Spahiu:

Në lidhje me bujqësinë, me vaditjen. Çdo vit në bashki vjen fond nga qeveria për edhe për pagat e punonjësve, por edhe për investime për vaditje. Megjithatë, përveç këtyre fondeve që vijnë çdo vit, në Dibër, të paktën, po bëhen edhe vepra të reja vaditëse, ose nga ato që kanë qenë ekzistuese. Po përmendi këtë në fund, meqënëse përmendët Maqellarën. Në Maqellarë është fondi prej, nga Ministria e Bujqësisë, prej 9 milionë dollarë. 2 milionë faza e parë ka mbaruar ujësjellësi, ujëmbledhësi i blacës dhe po vazhdon pjesa tjetër që të vaditen edhe 500 hektarë tokë në Maqellarë. Për herë të parë tani, nga '97-ta, do të arrihet që të vaditen këto 500 hektarë tokë në Maqellarë. Për numrin e punonjësve, ka një statistikë që merren këto të bashkive, ka një libër statistikor për punësimet, edhe besoj që Dibra del e vitit 2024-2025, nuk ka ardhur, është poshtë mesatarës së Republikës për sa i përket numrit të punonjësve. Po mos harroni se në këtë numër total të numrit të punonjësve që duket se ka rritje, janë edhe punonjëset edukatore të kopshteve dhe çerdheve, që për shembull, në Bashkinë Dibër janë 250, janë vetëm punonjëse në kopshte dhe çerdhe. Pastaj rritja e fondit të pagave, rritja e pagave çdo vit ka pasur influencë në rritjen e asaj indeksit të. Këtë kisha.

Arbjan Mazniku:

Atëherë, faleminderit. Zoti Bojni.

Altin Bojni:

Po, për sa i përket, po e nis për sa i përket numrit të punonjësve, apo pjesës që është e tetëfishuar, pas reformës territoriale, në Bashkinë e Madhe, pas disa ndryshimeve, numri i punonjësve të këtyre administratës ka ndryshuar ndër vite. Kur vlen të përmendi, numri i punonjësve të aparatit nuk ka ndryshuar. Numri i punonjësve të aparatit është më i vogël sesa kur kanë qenë ish-komunat. Nga 173, bëhet fjalë të jemi me 112 punonjës aparati, ndërsa stafin mbështetës ka disa ndryshime në shifra e të cilat kanë ardhur nga transferimi i kompetencave që kanë ndodhur vit pas viti, që do të thotë vaditja, pyjet, zjarrfikësët, si dhe ndryshimi i ofrimit të shërbimit ndaj qytetarit, ku pastrimi, mirëmbajtja e varrezave, mirëmbajtja e shkollave, rruga rurale, kanalet vaditëse, ngrohja e shkollave kanë qenë realizuar me anë të kontratave me palë të treta, ndërsa sot këto shërbime ofrohen nga strukturat të ngritura pranë Bashkisë së Madhe. 2015-ta, 179 punonjës. 2015-2019, kur kanë qenë kryetarë të bashkive, nga është lënë me 419 punonjës. Nga 2019 e sot është 419, por kjo është falë se në 2019-n janë prishur edhe kontratat e mirëmbajtjes së pastrimit të qytetit, edhe i ka kaluar si pastrim publik, që do të thotë me punonjësit e mirëmbajtjeve, të mirëmbajtjeve të varrezave, të shkollave, të kanaleve të vaditëse, edhe ngrohja e shkollave kanë realizuar që kjo të jetë edhe më me punonjës më shumë. Po do t'i shikohet edhe nga shifrat. Të gjithë ndryshimet në dorë ka ardhur si rezultat i ndryshimit të modelit të shërbimit ndaj qytetarit. Për sa i përket të ecit, nuk kemi pasur probleme për pjesën e ndoshta për tarifën, apo për probleme për përmbytjen e tokave, se këtë për përmbytjen e tokave, për tarifën. Për sa i përket, ne tani është vendos, është vendos një tarifë. Po, është vendos tarifë, është bërë një tarifë mjedisi për sa i përket ecëve, jo vetëm për ulëzën apo shkopenin, edhe për të gjithë pjesën e ecëve të tjera. Kurse për tarifën e pronës, ecët nuk

është se është në, nuk kemi tarifë prone për pjesën e ecëve. Do ta rishikojmë në qoftë se do jetë, do ta rishikojmë në qoftë se do të jetë e mundësia që. Absolutisht do ta shikojmë.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Bojnar. Zoti Elezi.

Ermal Elezi:

Faleminderit, bashkëkryetar. Atëherë, u prek pak a shumë dhe do të doja ndoshta më shkurt këtë pjesën e shërbimeve në kuadër të territorialitetit. Pra, ju unë dëgjova që ka vështirësi në disa shërbime që të ofrohen dhe do pyesja: a është harta aktuale më e mira për të ofruar këto shërbime? A do ishte një hartë që u propozua këtu, të paktën nga kolegu i opozitës, për një fragmentim bashkish, apo do ishte për një zgjerim kompetencës të bashkive dhe këtu fus edhe bashkimin ndër, edhe bashkëpunimin ndërbashkiak, që nuk e di sa përvojë ka bashkia juaj, qoftë në bashkëpunimin ndërbashkiak midis jush, por edhe bashkëpunimi ndërbashkiak me vendet kufitare, duke qenë se përfitoni nga programet e Bashkimit European, apo do kishim një format tjetër që është një decentralizim i thelluar për sa i përket njësive administrative? Sepse decentralizimi nuk është se mund të ndalet vetëm nga niveli qeverie qendrore, njësie vendore, por dhe njësia vendore vetë ka mundësinë, qoftë me rishikim të njësive të administrative, ia lejon ligji 139 të numrit, t'i uli, t'i shtojë, por dhe t'i delegojë kompetenca. Kjo është pyetja e përmbledhur e parë, që unë do të doja të kuptoja çfarë skenari për ju vlen më shumë në këto hallka. Pyetja e dytë ka të bëjë me atë që dëgjova nga ju, që ka të bëjë me kërkesën për më shumë kompetenca dhe kompetencat që kërkonin janë të larmishme, sepse nuk janë të njëjtat, që na çon në një asimetri. Por gjithsesi dëgjova që do ju përgëzoj për pjesën e stafit në Bashkinë Kloss, por doja të kuptoja a janë të specializuar stafet e burimeve njerëzore që ju keni për kompetencat që ju kërkonin? Fjalëabie, rishikim plani vendor, ekziston stafi për të bërë këtë gjë? Ose edhe për sa i përket shërbimeve të kadastrës, që kërkon profile të ndryshme: inxhinier, arkitekt, jurist të specializuar për çështjet e pronës e një sërë funksionesh. A ndodhen këta stafë të specializuar pranë bashkisë? Dhe pjesa e fundit që do kam është që, në rast se do kishit propozim të rishikimit konkret të formulës, sepse flitet për ekualizim aty ku bashkitë nuk kanë mundësinë t'ia dalin me të ardhurat e veta, duhet të thënë që formula aktuale ka një bazë të shëndetshme dhe të fortë të ekualizimit. Dhe ekualizimi po, mund të ndodhi jo duke i marrë bashkisë tjetër, por duke i bashkisë, se kjo cënon autonominë vendore, por duhet një propozim konkret se si ju e shihni që kjo metodë të jetë e vlefshme për të gjithë, jo vetëm për bashkitë e juaja, që në rast se ju keni një argument të bazuar përtej formulës aktuale siç ekziston, nuk ka nevojë të jetë sot, do e mirëprisnim me qëllim që ta marrim konsideratë në propozimet tona. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Cili nga kryetarët do të përgjigjet? Po, zonja Kola.

Valbona Kola:

Hartës aktuale, në fakt në Bashkinë Kloss, Bashkia Kloss ka një territor prej 357 km², ku është e vendosur në qendër si bashkia dhe e bashkë largua me të gjithë fshatrat, ku fshati më i largët që unë përsa përmenda është 40 km larg nga qendra e bashkisë. Ëh, unë jam dakord që të mos ketë ndryshim të statusit juridik apo të territorit të kësaj bashkie, se relativisht është e mbuluar me shërbime me këtë territor që është. Për sa i përket kompetencave, në fakt, ëh, ëh, janë disa kompetenca për sa i përket edhe, ëh, sistemit të vaditjes dhe të kullimit. Ëh, bashkia e Killosë është në territor është bashki rurale dhe më shumë mbahet nga prodhimet bujqësore dhe blektorale, ku pothuajse të gjithë janë fermerë të vegjël me atë sipërfaqe toke që prodhojnë dhe e shesin dhe mbajnë familjet e tyre. Ëh, kemi pasur vëmendjen e duhur për sa i përket investimet në kanalet vaditëse apo në diga, por që, ëh, kemi kaluar, janë kaluar kanalet dytësore dhe tretësore, por diga dhe kanalet parësore jo akoma. Ne në fakt në bashkinë e Killosës, në territorin tonë, gjithë lugina vaditet me një kanal parësor që është nën juridiksionin e bordit të kullimit, por në fakt, ëh, akoma nuk është në funksion këtë radhë dhe të gjithë njerëzit trokasin në derën e bashkisë për të marrë shërbimin e vaditjes, se thotë kryetari ty të njoh dhe ne gjithë munda dhe djersa, po na shkon kot sepse ky kanal akoma nuk është në funksion për të vaditur. Ëh, jemi për sa i përket kadastrës, unë thashë që.

Ermal Elezi:

Vetëm një gjë, një moment. Keni ekspertë ju për të menaxhuar digat ose funksione të cilat ju thonin që po kërkonit të sistemeve të vaditjes?

Valbona Kola:

Po, për sistemet e vaditjes, ëh, për digat nuk mund të them që e marr përsipër, ëh, digat, por vaditjen po. Ne po mundohemi shumë për kanalet dytësore dhe kanalet tretësore, ëh, t'u përgjigjemi në kohë të gjithë banorëve në kohën e vaditjes, ngaqë jemi zonë rurale dhe që mbahen me prodhimet bujqësore gjithë banorët e zonës tonë. Ëh, Killosi në fakt e ka pasur si traditë edhe tregtinë, ëh, mban, është hambari i Burrelit, i Bulqizës, i Killosës, po sot me rrugën e Arbrit shumica e tregtarëve, e fermerëve, ëh, mbajnë edhe një pjesë të tregut të Tiranës, siç është Njësia Administrative e Xhiprit, nga Keta në Xhipërmurizë dhe në Xhipërhanë edhe Shkallë që e mbajnë me domaten, me pataten, me fasulen. Kështu që është shumë e domosdoshme, ëh, një vëmendje më e madhe edhe për sistemin e vaditjes. Janë, ëh, rreth 600 km kanal, ëh, të kanale parësore, dytësore, tretësore dhe kulluese në territorin e bashkisë Killosë. Për sa i përket kadastrës, me shumë të drejtë, mbase ne na pëlqen t'i kemi kompetencat sepse, ëh, gjithë shpresa është e madhe për të vjelë të ardhurat, kështu që këtë radhë kemi siguruar dhe pak buxhet për regjistrimin e pronave, kemi hedhur hapin e parë, ëh, ndërkohë dhe me rishikimin e planit vendor, ëh, ndërkohë që edhe rruga e Arbrit ka bërë të veten që njerëzit ta kthejnë kokën përsëri në vendlindjen e tyre. Kemi shumë kërkesa, ëh, për të zhvilluar, për të ndërtuar, ëh, mbase nëse kadastra kalon nëpër bashki do krijohen të gjithë mundësitë edhe për një staf apo një ekip të, pa diskutim.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit zonja Kolja. Po, zoti Spaju.

Rrahim Spahu:

Shtoj diçka për sa i përket, shtoj diçka për sa i përket njësive administrative, është e vërtetë që Dibra ka, ëh, 15 njësi administrative. Është e vërtetë që e ka bashkia dhe Këshilli Bashkiak kompetencë për shtimin ose shkurtimin e këtyre njësive administrative dhe besoj që në Dibër sot është koha që nuk duhet të jenë 15 njësi administrative. Po marr zonën për shembull, Rreçi, me Zaldardhën, mund të jetë një njësi administrative. Ose, ë? Po ato i braktisëm, i braktise, ikët ti i pari, unë i dyti, unë u ktheva prapë të shtoj, po ikin. Jo, është e vërtetë që janë braktisur dhe tani dhe kush e tani po kthehen. Edhe zonën e Rreçit, ku është vendlindja jote, ka shumë kërkesa për rregullimin e shtëpive, për ndërtim e shtëpish të reja, që janë të interesuar për rrugë, për shërbime, për gjëra, kështu që besoj që kemi fjalë avash-avash do, do popullohen edhe ato zona përsëri. Mbase në atë fazë si kanë qenë jo, po.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zonja mjeshtri.

Festime Mjeshtri:

Atëherë, nëse Bulqiza do të bëhej bashkëri më e madhe, atëherë do të ekzistonte rreziku i shërbimit ndaj qytetarit do të ishte më i vështirë. Prandaj, bashkia e Bulqizës do të qëndrojë bashki me vete, për shkak se mban dhe peshën më të madhe të popullsisë, e dyta në qark, që duke qenë më afër qytetarëve, shërbimet të jenë më afër dhe nuk është e nevojshme që kjo bashki të kalon minoritetin vete, nen vete, sepse kjo është e vërtetuar që para 2014-s ato komuna që pretendojnë që të bëhen si shtotë opozita të bëhet bashki, nuk kanë pasur asnjë lloj shërbimi. Që tani shërbimet, ne e dimë që territori është i vështirë, investimet përqendrohen gjithmonë në pranë territorit të bashkisë, por gjithashtu kemi filluar punën ku është minimizuar rruga, janë minimizuar shërbimet, ku mendoheshte që të shkon makina e pastrimit në Trebisht, apo në Ostrenj, apo në Krasë. Tani kemi vepra strategjike që shërbimi ndaj qytetarit është më afër. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Zoti Bojni.

Altin Bojni:

Për sa i përket hartës territoriale, bashkia e madhe, ëh, ka eksperiencën që ka krijuar në dhe e gatshme për të ofruar shërbimin për territorin aktual që ka në çdo cep të bashkisë së madhe. Për sa i përket kompetencave, stafët janë të specializuar dhe se vetëm po të marrim sektorin e projekteve, ne jemi ndër tre bashkitë e para që kemi për tërthithur më shumë fonde në Bashkimin Europian.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Ëh, zoti Likaj.

Ramadan Likaj:

Faleminderit, bashkëkryetar. Faleminderit kryetarit se jeni sot të pranishëm këtu. I dëgjova me shumë vëmendje përgjigjet edhe pyetjet që i bënë kolegët. Unë duhet me qenë pak më konkret si ish-kryetar bashkie dhe besoj që ne i dimë hallet edhe problemet që kanë territoret. Sigurisht që ne nuk jemi sot këtu për të kërkuar maksimumin e maksimumit tuajën, por besoj që duhet të jem konkret në pyetjet edhe në diskutimin që unë do mbaj. Në qoftë se sot po ridiskutohet edhe njëherë ndarja ose ndarja e re territoriale, sigurisht që reforma e 2014-s nuk ka dhënë pritshmëritë e duhura. Besoj që këtu biem dakord të gjithë. Unë dëgjova edhe përgjigjet tuaja, edhe pyetjet e kolegëve. Nuk dua t'u rikthehem shumë atyre, duhet të jem pak më konciz. Ëh, në qoftë se sot Kllosit do i kërkohej të bashkohet me Bulqizën, do ta pranoni? Pyetja e parë. Dhe, më falni, Kllosi me Matin dhe Bulqiza me Tibrën. Sot dihet se zonat tuaja janë zona bujqësore. Sigurisht që Ministria e Bujqësisë ka shumë kompetenca dhe në aspektin e përgjithshëm bashkitë gjithmonë kanë problemet e veta dhe druhen për mirënjohje të zërin për me marrë ato kompetenca që realisht i kërkojnë më shumë bashkive se Ministrisë së Bujqësisë. A mendoni ju që disa kompetenca që Ministria e Bujqësisë ose Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë t'i kalojnë bashkive? A mendoni që këto shërbime ishin me qenë më shumë mamje? Dëgjova Bulqiza 63 fshatra sot. A mendoni ju se shërbimet mas reformës 2014 e deri sot janë më të mira se ishin para 2014-s? Flas te investimet gjithmonë. Dhe një pyetje konkrete e kam për katër bashkitë. Si ishin investimet komuna që sot janë në territorin e bashkisë tuaj, investimet e katër viteve pra, 2020-2000, më fal, 2000-2014 dhe 2016-2026? Nëse keni mundësi, nëse i keni këto statistikat, besoj që duhet t'i keni. Oferta e pakushëzume, që realisht turbullohet më të madhe nga të gjithë kryetarët e bashkive, pse është shumë e ulët. Rajoni sot e ka 5-6. Kur Shqipëria vazhdon të jenë ato shifra minimale që realisht nuk hyjnë as në problemet e veta. A mendoni ju si kjo gjë duhet të jenë, të paktën të kapim shifrat e rajonit 5-6? Dhe u diskutua edhe u përmend ujësjellëset, ujësjellës kanalizimet. Të gjitha problemet sot të ujësjellësit mbahen çdo qytetar shkon te bashkia. Aty përplasen çdo gjë. Dhe në këtë kontekst unë them që, a mendoni ju që ky, kjo gjë, ky shërbim t'i kalojnë përsëri bashkive? Sigurisht t'u rritë edhe fondet minimale qeveria ndaj bashkive për me dalë prej kësaj situatë. Pak a shumë këto ishin këto që unë, se mos zgjasim edhe kohën me ju shumë.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit gjithë juve. Zoti Spaju.

Rrahim Spahiu:

Atëherë, për pyetjen e parë për bashkimin e Bulqizës me Dibrën, e thashë që në fillim të fjalës time, pak interes nga kryetarët e bashkive kemi nëse bashkohen edhe apo ndahen më shumë. Nevojë kemi për ato të jenë të qarta ato detyra që ka bashkia dhe. Dhe pse jo të ketë më shumë kompetenca bashkia. Për sa i përket të dytës, për Drejtorinë e Bujqësisë meqë janë zonat e Qarkut të Dibrës, një vend bujqësor elektoral, nuk kemi qenë dhe nuk

jemi ne kryetarët e bashkive asnjëherë kundër rritjes së kompetencave të bashkive. Sidomos ne veriorët e kemi qejf sa më shumë kompetenca të kemi, duhet pigura më të mirë. Por nuk ka munguar edhe kështu si janë bashkëpunimi me Drejtorinë e Bujqësisë, se Drejtoria e Bujqësisë thjesht merret me subvencionet, me të gjitha ato, po këto të gjitha këto i bën në bashkëpunim me bashkinë. Është e vërtetë që i ka mbi vendosje Drejtori i Bujqësisë në bashki, Drejtori i Bujqësisë në që është që varet nga Ministria e Bujqësisë, po gjithsesi këto dy drejtori bashkëpunojnë dhe nuk ka pasur asnjë problem në lidhje me bujqësinë dhe blegtorinë në përgjithësi në Dibër. Statistikat për zhvillimin, me thënë të drejtën, statistika s'kemi, mbase do ua sjellim edhe me shkrim 2000-2014, 2014-2026, po është e vërtetë të paktën pas statistika që janë bërë shumë e shumë rrugë, shumë e shumë shkolla, shumë e shumë ujësjellësa, për sa i përket periudhës 2014-2026. Edhe ato që ta biem zyrtare me fondet, e duket që nuk bëhet fjalë për dyfish e trefish, po do bëhet fjalë për pesëfish e dhjetëfish më shumë. Të paktën nga ato që i kam kalkuluar afërsisht me mendje. Për transfertat, transfertat, rritje sa më shumë transfertat të kemi, më mirë është. Është e vërtetë që çdo vit kemi pasur rritje transfertash, po ka edhe një diçka tjetër që bashkitë që, se bëri një pyetje deputeti i Dibrës, fillim, bashkitë që kanë pasur probleme në fundvitit, që bëhet fjalë për bashki të vogla që gjenerojnë pak të ardhura, çdo fundviti me vendim qeverie bëhet një korrigjim edhe këtyre bashkive që kanë buxhete të vogla, mungesë fondesh, u bëhet një korrigjim dhe në fundvitit u dërgohen një shtesë fondi duke parë bashkitë që janë me më me pak të ardhura. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zonja Kola.

Valbona Kola:

Për sa i përket pyetjes së parë, nëse ne do ishim dakord për të ndryshuar territor apo për t'u bashkuar me Matin. Në fakt, ne po i mëshojmë shumë bashkive të vogla këtu, se Klosi është bashki e vogël dhe po ju them sinqerisht që në Klos ka kohë që diskutohet reforma nëpër tavolina apo në stafin e bashkisë që bashkia mund t'i bashkohet një bashkie tjetër. Realisht nuk besoj që madhësia e vogël nuk do të thotë domosdoshmëri ose paaftësi për t'iu dhënë shërbim qytetarëve. Ne thamë që reforma territoriale e vitit 2014 ka sjellë zhvillime pozitive në bashki, si në të gjithë bashkitë, në fakt edhe në bashkinë e Klosit, duke patur përmirësime shumë në organizimin administrativ, në rritjen e kapaciteteve institucionale dhe mundësinë për më shumë investime në territor. Dhe investimet në territor janë bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë, duke u ndarë në të gjithë territorin, në të gjithë njësitë administrative, duke i dhënë më pak vëmendje, të them të drejtën, këtë radhë qendrës së Klosit, asaj qendrës së vogël, por edhe përfaqësia ka qenë nga të gjithë njësitë administrative. Unë them që ka qenë e suksesshme për bashkinë e Klosit, sepse edhe në lidhje me investimet, dhe unë kam vetëm një shifër këtu, investimet nga 2016 deri në 2026 dhe ka një trefishim të përqindjes për frymë të investimit. Në vitin 2016 ka qenë 2800 lekë për frymë, ndërsa në vitin 2026 ka arritur 9000 lekë për frymë edhe mund të jetë e ulur, por që ka një rritje të ndjeshme të investimeve, falë mbështetjes së qeverisë, pa diskutim, sepse bashkia është bashki e vogël, është me pak të ardhura, por që mbështetja ka qenë

e mjaftueshme për të investuar. Në fakt, këto tre vite, unë flas, thashë flas edhe për 2014-n e këtej, sepse e njoh mirë territorin, ka bërë ndryshime të konsiderueshme në të gjithë territorin e bashkisë. Sot që kemi një potencial të mjaftueshëm për zhvillimet e turizmit edhe falë rrugës së Arbrit, bashkia e Klosit, edhe pse bashki e vogël që mund të konsiderohet, por që është bashki me identitetin e vet, me trashëgiminë e vet, në fakt edhe unë jam bi-klosiane dhe e ruaj këtë identitet të Klosit. Për sa i përket ujësjellësit, nëse e porosi e kam edhe nga klosianët, nga banorët e mi, kryetare, të lutem, na e ruaj bashkinë. Se mendoj që edhe bashkia e Klosit po do bashkohet me bashkinë e Matit. Ju lutem, më bë të një pyetje dhe po ju kthej përgjigjen. Bashkia e Matit, dmth duke u bashkuar me bashkinë e Matit, pa diskutim, po pa diskutim mendoj që e largon pak vendimmarrjen nga banorët apo dhe shërbimin, kështu që shpresojmë shumë që ky territor të ngelet i bashkisë së Klosit, kështu siç është. Për sa i përket transferteve të pakushëzuar, sepse ne i kemi mëshuar fort si kryetarë bashkisë, sepse është një nga shtyllat kryesore, dmth ku ne mezi presim që të na vijë kjo transfertë në fillim të vitit, për të planifikuar bashkë me ato të ardhura që mbledhim edhe investimet tona, prioritetet tona, në fakt. Unë nuk mund të jap një mendim se si, besoj që ka mjaftueshëm ekspertë të fushës për ta dhënë një mendim të tillë. Ndërsa për ujësjellësin, unë fola më përpara që ujësjellësi ka bërë ndryshime kolosale. Në ujësjellës është investuar shumë. Ne në 2016-n sapo e thashë që vetëm 20-15% e popullsisë furnizohet me ujë të pijshëm, ku sot në të gjithë territorin e bashkisë së Klosit furnizohet rreth 95% e banorëve. A ka problematika? Ne nuk mund t'i shmangim, nuk mund të themi jo, sepse jemi këtu edhe që na dëgjojnë edhe qytetarët që janë atje. Edhe thashë që të parët që trokitet për të zgjidhur hallin është kryetari i bashkisë, por unë e kam zgjedhur më mirë ta zgjidhë vetë hallin sesa të sorollas banorin për të zgjidhur një problematikë. Përderisa ne jemi bashkëaksionerë në këtë SHA, në këtë shoqëri, duhet të bëhemi të gjithë bashkë për t'i zgjidhur problematikat.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zonja Kola. Zoti Bojni.

Altin Bojni:

Atëherë po e nis për sa i përket transferteve. E thamë dhe më përpara, mirë do ishte që të jetë 2 deri në 5% pjesa e transferteve, se në momentin që do jetë 2 deri në 5% do kemi dhe mundësi dhe më shumë edhe për investime, edhe do jetë nga ana e financave dhe më e fortë edhe pjesa e bashkisë. Për ujësjellësin, apo është ashtu edhe për pjesën e drejtorisë së bujqësisë, për pjesën e kompetencave, janë kompetencat që çdo hall, çdo problem, çdo shqetësim që janë tek pjesa e banorëve, qytetarët, patjetër që po flasim tek kryetari i bashkisë, patjetër që duan të marrin zgjidhje nëpërmjet kryetarit të bashkisë. Jo që nuk kanë funksionuar. Të dy si drejtorja e bujqësisë apo qoftë edhe drejtorja e ujësjellësit ka funksionuar. Bashkëpunimi nuk ka munguar. Mund të jetë, mund të jetë edhe më mirë për sa i përket ujësjellësive. Edhe më përpara për sa i përket investimeve janë bërë shumë investime në bashkinë Mat në ujësjellësa, apo qoftë edhe te kanali i ujërave të zeza që është bërë sot, është bërë dhe impianti, kështu që edhe mund të kalojë si kompetencë, mund të jetë një nga ato pjesë pjesët që e vendoset nëpërmjet kësaj

reforme. Për sa i përket investimeve që ishte në 2016, 2020 apo 2020 dhe 2025-ën, bashkia e Mat ka pasur në. Duke pasur mbështetjen edhe të qeverisë, apo qoftë dhe nëpërmjet ministrive, ka pasur një investim të konsiderueshëm dhe është një nga ato bashki që ka pasur investime të mëdhaja. Për sa i përket bashkimit të Klosit, Matit, Mati me Klosin, e Klosi me Matin, është një pjesë, është pjesë e reformës territoriale që po merret me grupe ekspertësh edhe pjesës së saj. Unë po them për bashkinë Mat për territorin e bashkisë Mat aktual që kam. Ne jemi, kemi eksperiencë edhe kemi shërbimet kudo që ne kemi në njësitë administrative edhe nuk jemi ne ato që do ta vendosim për sa i përket bashkia Mat në këtë territor që është, është në rregull. Shumë faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Bojni, zonja Mjeshtri.

Festime Mjeshtri:

Atëherë çështja është, t'i referohem pyetjes për bashkimin e bashkive Dibër-Bulqiz. Çështja është, nuk është se pranojmë të bashkohet apo jo, po unë do të jap thjesht argumentin tim, siç e theksova dhe më parë që është bashkia e dytë në qark me peshën e popullsisë më të madhe. Ka një territor goxha relativ dhe të shpërndarë, 678 km². Ka goxha, është një bashki që ka një industri minerare, ka shumë zhvillime siç është bujtina. Tani Bulqiza po kthehet në një qendër të rëndësishme turizmi dhe qëllimi i reformës është këtu që të përmirësohet, që të rishikohet dhe jo që të bashkohen bashkitë. Kurse për sa i përket shërbimeve, duke krahasuar me reformën e vitit 2014, normalisht që shërbimet janë më të mira. Të flasim për Bulqizën, kur mendoheshte para vitit 2014 të kesh qendër inore, kur mendoheshte të ketë qendër të moshuarve, ku investime madhore siç janë në të gjitha njësitë administrative, ke mbaruar punë me fshatrat, tani kanë filluar infrastrukturën dhe nëpër lagje ku kanë katër e katër shtëpi. Dhe kështu që bashkia e Bulqizës ka shumë faktorë që duhet të jetë e qëndrueshme dhe duhet të jetë bashki. Dhe qëllimi jonë është që të jemi më afër qytetarëve për t'u shërbyer atyre sa më mirë. Kurse për pjesën e ujësjellësit, siç e theksuan edhe kolegët, ne jemi aksioner, normalisht që duke kaluar në shanin vete. Investimet janë më të mëdhaja, problematikat qytetarët i bien në bashki, po jemi munduar së bashku me drejtorinë rajonale që të jemi sa më pranë qytetarëve për të zgjidhur hallet dhe problemet ku vërtetë i prekin qytetarët. Kurse për pjesën e transferteve, kush është kryetar bashkie që nuk do të deshte më shumë transferte? Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zonja mjeshtrë. Zoti Lika, një koment të tuaj.

Ramadan Likaj:

Për kryetarin e bashkisë Dibër. Po në qoftë se ti nuk je në gjendje të më thuash mua, të më bësh një pyetje konkrete, si janë këto investimet deri në vitin 2014 dhe ti nuk i dha përgjigje, ti nuk i ke ato statistika, paske statistika që janë rritë investimet. Pesëfishin gjatë

kësaj periudhe kur ti nuk ke statistikë për pyetjen time, si është të mujtun? Nëse ke mundësi të ma ilustrosh pak, të lutem. Thjesht ajo sa për kulturë, jo për na gjë.

Rrahim Spahiu:

Ta sqarova që statistikën do ta sjell me shkrim. Statistikën do ta sjell me shkrim.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zoti Spahiu. Atëherë faleminderit për pyetjet, zoti Boçi.

Luçiano Boçi:

Në fakt kam dhe unë diçka të vogël. Nuk ju dëgjova të gjithë për shkak dhe të angazhimit në një komision tjetër, por fillimisht kur dëgjova dy kryebashkiakët, më kujtua dhe më lejoni ta them në fakt, një barsaletë e kohës së rinisë time, kur dikush pyet një oficer të ushtrisë së Zogut për shkak të krizës dhe i thotë: "Si e bëni me ushqimin ju atje?" O tha ai, "Na delta dhe na tepron." Po me tepricat tha ai, "I hamë tha dhe s'na dalin." Kështu është edhe kjo puna juaj, dmth ju jeni shumë mirë, shumë, shumë mirë, fshatrat nuk janë braktis, shërbimet shkojnë njësoj si në qendër, si. Po doni dhe më shumë lekë, se po edhe ato s'ju dalin. Prandaj thashë unë në fillim, duhet të flasim sinqerisht dhe qartë, cilat janë kërkesat tuaja dhe midis tjerave unë kam dhe një, meqënëse janë thënë dhe unë kam një merak shumë të madh për këtë që nuk është thënë. Tek erdha këtu, lexova një artikull nga një, të themi, media prestigjioze, shumë prestigjioze është dhe përcakton që nga 2021-sh-i deri tani Shqipëria ka humbur 166 mijë njerëz, banorë dhe ndër qarqet më të shpopulluara është qarku juaj, qarku i Dibërës, është në alarm të kuq dhe braktisja e fshatrave nuk është braktisje vetëm me rezultat zero, braktisje quhet edhe kur ka 20 banorë që janë mbi 60 vjeç, edhe kur ka 40, edhe kur është mbyllur shkolla, se për shembull dje kemi prekur një realitet në Skrapar, që ikëm për një rast jo të mirë, por që pamë dhe gjëra jo të mira, shkolla e mbyllur, qendër shëndetësore jo. Pra edhe në këtë rast kemi braktisje, sepse mungojnë shërbimet, shkolla është shërbim, shëndetësia është shërbim, kanalizimet janë shërbim, rruga është shërbim, shumë mirë që është afruar Lura. Ne këtë do donim, pikërisht zoti Spahiu, ne këtë kërkojmë që të realizohet investimi, rrjeti rrugor, pastaj të flasim për bashkimin e bashkive, se ka një standard evropian që thotë 30 minuta larg, aksesueshmëria, arritshmëria dhe nuk është momenti për të folur tani për bashkimin e bashkive, se nuk ekziston infrastruktura, nuk ekziston përfaqësimi, nuk ekzistojnë shumë elementë dhe ne në një pikë edhe takohemi që ato që janë të vogla dhe konsiderohen të vogla sipas, se është shumë relative sipas 2014-s, qëndrojnë, sepse është një anije që lëviz dhe merr krah shumë më shpejt sesa një anije e madhe, një bashki e madhe, e cila nuk arrin të performojë aq mirë në fleksibilitetin e saj, fleksibilitetin e shërbimit që duhet të ofrojë. Por pyetjen unë e kam për shpopullimin. Ju ndesheni me këtë realitet. A keni hartuar ju si bashki një strategji reale për ruajtjen e popullimit, frenimit të shpopullimit dhe krahas kësaj, se jeni katër vite në detyrë, a keni parashtruar një strategji për ripopullim? Se shifrat janë shumë alarmante dhe pyetja e dytë e imja është në raport me transferteve, që këtu shumë mirë u tha nga Altini që edhe tre edhe pesë, po, ne jemi, dmth për më shumë transfertë pakushtezuar, model i financimit të pushtetit lokal nga

qeveria qendrore, sepse taksat tona janë ato, të qytetarëve tuaj, qytetarëve të gjithë Shqipërisë, që t'ju jepen juve në formën e pakushtezuar, transferteve të pakushtezuara, që të keni autonomi t'i përdorni për nevojat, shërbimet, funksionalitetin, kompetencat tuaja. Sot ajo shpërndahet në masën 1%, as 1%, 0.9% është e PBB-së. Sot ndahet në bazë të dy kriterëve: territori dhe popullsia. A jeni dakord që transfertat të ndahet edhe sipas largësisë, sipas varfërisë, sipas relievit, dmth? A jeni dakord? Dhe në qoftë se jeni dakord, parashtrojeni si kërkesë, se jo patjetër duhet të dalë nga ne si pyetje, që ju ta keni një kërkesë, kjo është dëgjuesë në fakt, e ka këtë lloj ballafaqimi, por ju duhet ta shprehni saktë. Duke gjykuar që pushteti lokal është pushtet lokal, nuk ka të bëjë me individët, me qenien e kryetar bashkie të X-it apo Y-it, ka të bëjë me shërbimin ndaj qytetarit. Çdo kryetar bashkie ka mandatin e vet, zëvendësohet, por ama gjurma që lë ai, shërbimi që i bën ai bashkisë është shumë, shumë i madh. Për mos të shtuar pyetje tjera për funksionet apo kompetencat, që besoj janë bërë këtu edhe nuk kam drejtë, dmth që të ribëj pyetje që ndoshta janë parashtruar, unë desha përgjigje vetëm për këto dy pyetje. Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Po, zoti Spahiu.

Rrahim Spahiu:

Është e vërtetë që Dibra hyn në ato bashki që është bërë shpopullim, kanë lëvizur, kanë lëvizur njerëz, por e dimë të gjithë që Dibra ka qenë xhepi i Shqipërisë. Duheshte për të shkuar në Dibër pesë orë deri në gjashtë orë, për të shkuar në Dibër e vajë hallin në fshat. Edhe kjo ka qenë një ndër arsyt kryesore që ka lëvizur. Pastaj njerëzit janë të lirë, lëvizin. Unë isha së fundi në Korfuz edhe kur pashë që edhe nga Korfuzi kishin ikur njerëz nga Greqia, do të thotë që kjo ka qenë jo vetëm për Dibërën e për Shqipërinë, por ka qenë për shumë vende të tjera. Të dalim nga ajo se çfarë po bëjnë, çfarë po bën bashkia për kthimin e këtyre njerëzve, për popullimin e këtyre zonave që janë braktisur. Në fakt ne patëm një fat te Dibërës, që rruga e Arbrit po na e lehtëson pak punën për kthimin e këtyre njerëzve atje. Dhe këtu e shohim që po kthehen shumë njerëz nga kërkesat e mëdha që ka për ndërtim pallatesh. Në qoftë se deri tani janë ndërtuar tre pallate dhe janë shitur që është ngropë, ka kërkesa edhe për pesë pallate të tjera, që do të thotë që po kthehen njerëz. Ose po e shohim nga ato që po kërkojnë në të gjitha zonat për restaurimin e shtëpive, për ndërtimin e shtëpive të reja. Kështu që Dibra besoj që nuk do e ketë më këtë problem që ka pasur deri tani, kjo edhe falë rrugës së Arbrit. Pastaj për ato strategjitë që ka bërë bashkia, kemi punuar me organizata gjeovizitare, kemi pasur sidomos me ato angleze, me sensibilizimin e publikut, me marrjen e vendimeve aty që mos paguajnë çiftet e reja, mos paguajnë që hapin një biznes, mos paguajnë taksa vitet e para. Këto janë gjëra pastaj që ka bërë bashkia, por e rëndësishme është që Dibra me rrugën e Arbrit nuk do ketë më shpopullim, por do ketë njerëz që po kthehen.

Luçiano Boçi:

Një sqarim, zoti Spahiu. Për shpopullimin, unë thashë nga 2021-shi, sepse artikulli ishte sot. Dje ka qenë një tjetër artikull shumë i rëndësishëm, investigim mediatik. Shqipëria ka

humbur deri nga 2024-2025-ën për një vit 1.6% të popullsisë, gjë që nuk konvenon me atë që parashtruat ju. Dhe humbja e kësaj popullsie vjen kryesisht nga zonat malore, mos e shtrijmë kohë dhe të themi, por nuk mund të japësh argument që do ndërtohen dhe dy pallate dhe këto njerëz që do vijnë nga jashtë blejnë shtëpi, se s'kishin shtëpi edhe duan pallat të ri që të vijnë në Dibër. Nuk është ky koncepti i ripopullimit. Edhe nuk tregon kjo. Shifrat që jepen nga investigimet janë diferenca midis atyre që ikin dhe diferenca midis atyre që kthehen. Nuk janë në vlera relative. Dakord? Dhe pjesa tjetër e rrugës së Arbrit, unë dmth pëlqej për entuziazmin, unë vetë kam qenë po kaq entuziazm sa ty në 2013-ën, kur u ndërtua autostrada Tiranë-Elbasan. Edhe kam menduar që nuk do ikin njerëz nga Elbasani, nuk do ikin biznese nga Elbasani, sepse është shkurtuar rruga 20-30 minuta, por nuk është kjo, nuk e bën rruga atë njeriun të qëndrojë, e bën shërbimi dhe kanë ikur njerëz nga Elbasani, sa të duash, në këto ritme është dhe Elbasani për shpopullim. Madje dhe nga qyteti kanë ikur. Në emigracion, një pjesë e vogël ndoshta punojnë në Tiranë edhe e bëjnë çdo ditë këtë rrugë, se nuk mund të jetojnë në Tiranë me qira atë këtu. Ja pra që nuk është rruga ajo që përcakton, mos e ke, hiqe këtë entuziazëm. Se po ta dëshmoj unë. Unë thashë strategji, dmth mblidhet bashkia, vendimet e Këshillit Bashkiak me masa konkrete, me hartë të produkteve bujqësore, me stimulim të zhvillimit ekonomik, me ndihmë të bujqësisë, me ndihmë atë tjera, se është kryesisht rreth, më fal, qark bujqësor apo bashki që ka aktivitet bujqësor, masa konkrete, se ne kemi menduar se, ne kemi shumë dëshira mendojmë shumë gjëra, ne po themi çfarë realisht është bërë për ta frenuar shpopullimin. Për këtë sqarim e kisha dhe për përgjigjet që do mbijnë, dmth që mos përqendrohemi tek përsëritja. Faleminderit.

Valbona Kola:

Atëherë.

Arbjan Mazniku:

Po, zonja Kola.

Valbona Kola:

Atëherë për sa i përket shpopullimit, në fakt për Bashkinë e Klos e kam informacionin e saktë nga gjendja civile, që nga 2016-ta deri në 2026-ën, ashtu si në gjithë botën, por edhe nga Klosi i Vogël janë larguar rreth 970 e ca banorë. Që nuk është një shifër alarmante, sepse e kam përsëritur disa herë që fshatrat e Bashkisë së Klosit janë të populluara, mirë, dmth nuk ka fshatra të braktisur. Ka qenë plan i bardhë për ato që e dinë territorin dhe e dinë fshatrat e Bashkisë së Klos, që është populluar për shkak të ujit që u largua përpara shumë vitesh, nga '85-ta, me sa di, dmth me sa kam informacionin, për shkak të një tramverbangu që u ndërtu dhe bëri devijimin dhe largimin e ujit të vaditës, por sot falë investimit në ujë të pijshëm, fshati Plan i Bardhë, dmth një investim që kurrë nuk e ka ëndërruar dhe sot po merr ujë të pijshëm 24 orë dhe kemi kërkesa të mjaftueshme për të ardhur dhe për t'u rikthyer në vendlindjen e tyre edhe për të zhvilluar, jo vetëm për të jetuar. Në fakt po i mëshoj prapë rrugës së Arbrit, se është një investim në fakt që asnjëherë nuk duhet ta harrojmë, për atë frymëmarrje që i ka dhënë të gjithë qarkut të

Dibrës dhe më shumë. Dikur, përpara se të bëhej rruga e Arbrit, në fakt kam pasur një investitor italian për të hapur një bujtinë, atëherë isha thjesht mjek, më falni, një fasoneri, erdhi nga Shkopeti, pa rrugën, u largua, tha: "Unë nuk e kam të mundur të vij në këtë rrugë." Sot në fakt në Klos po hapen fasoneri dhe ka kërkesa mjaft për të zhvilluar më shumë. Kjo falë edhe asaj që ne strategjisë tonë, strategjia jonë fokusohet në, përqendrohet më shumë në investime. Ne e bëjmë komod t'i ndërtojmë infrastrukturën rrugore, ku unë po flas vetëm për trevjeçarin që unë kam punuar, po arrij 22 km asfalt dhe mendoj ta mbyll me 30 km asfalt mandatin tim, që nuk është pak për një bashki të vogël duke e mirëmenaxhuar. Jo vetëm infrastruktura rrugore që kërkohet më e madhe, por që edhe uësjellësat bëjnë që të kthehen në vendlindje, por edhe investimet e tjera dhe politikat e qeverisë, në fakt, që nuk duhet t'i harrojmë, që po u japin shumë mbështetje të gjithë emigrantëve, si me paketën e maleve apo me politika të tjera mbështetëse edhe për fermerët dhe janë mjaftueshëm, po kërkojnë çdo ditë, sepse hapi nuk hidhet, ne nuk hedhim dot me kërcime, por hapat hidhen një pas një për çdo të mirë që bëjmë për komunitetin. Kështu që besoj që edhe një qendër rinore tani po bëhet rikonstruksion për t'iu ofruar të rinjve, kemi bërë mjaftueshëm, pesë ura, gjashtë shkolla, shkolla e gjashtë fillon tani nga Fondi i Zhvillimit, dy nga Ministria e Arsimit, tre shkolla nga Efienca e Energjisë, në fakt, ku disa zona që nuk mbështeteshin në bashkëpunim me Bashkinë, i kemi bërë shumë mirë funksionale. Ndaj besoj duke investuar në çdo fushë, kjo është strategjia, ne nuk jemi në një strategji, por së bashku me Bashkinë dhe me Qeverinë Qendrore po bëjmë të pamundurën që të kthehen dhe në fakt fakti tregon që ka interes për të ardhur në vendlindje, qoftë edhe ato që jetojnë në Amerikë, edhe në Angli, edhe në Gjermani dhe kudo. Do ta gjejnë veten besoj shumë shpejt.

Luçiano Boçi:

Po, zonja Kola, faleminderit. Një ndërhyrje të vogël. Rezultojnë pesë shkolla të mbyllura në Hunjat, Plesh, Fshat, Dom edhe Shulbatër ose Shilbatër, mos jam gabim. Pra, unë kërkoja mbylljen, jo ato që ju keni në plan, në plan ose në mendje, mund ta fikni dhe mikrofonin. Ndërkohë, e di kush është frika ime që e paralajmërova, zonja Kola, unë kam frikë se duke ju dëgjuar kryeministri, se është shumë i interesuar për Komisionin e Reformës Territoriale, do të thojë që këto s'paskan nevojë as për 1%, se unë ja paskam dhënë të gjitha, është si ajo historia, duartrokasit, tha: "E shtrëngoja më shumë, tha se mirë qegën." Ndërkohë që ne kemi synim tjetër, dmth si Komision, që t'ju japim sa më shumë juve, ju vetë, unë e shoh që nuk e doni dhe ju lutem shumë, gjo, ju lutem shumë, jo me lavdërime administrative, jua shpjegova që në fillim, por kam frikë se nuk e keni dëgjuar, se në fakt ne jemi opozita dhe unë e di çfarë ndodh. Mos na thoni si në gjithë botën ka nikë nga Klosi, se nga gjithë bota vetëm po patë nikë në Mars ose në Hënë apo? Se nga gjithë bota jo, s'ka nikur, iki nga Shqipëria, iki nga vendet e varfra, iki nga vendet ku s'ka shërbim, se detin nuk e kalojnë italianët, me notë, apo jo? Ikin se s'ka shërbime dhe nga të gjitha, të themi statistikat, që vijnë nga Europa, Europa është me rritje numri i banorëve, Shqipëria është me ulje. Sa ka humbur Dibra? Nuk ka fituar Tirana nga censusi i 2021-shit, 15 mijë banorë ka fituar me census Tirana. Ka nikur jashtë shtetit, mos thoni si gjithë bota, kanë lëvizur, kanë lëvizur se është modë, se është trend, e kemi dëgjuar 1000 herë këtë, jo, jo, jo, ka nikur jashtë shtetit, ka nikur në emigracion, s'ka shërbime,

s'ka siguri shëndetësore, arsimore, ushqimore, po desha e lidhim edhe me Qeverinë Qendrore, se s'kemi dalë aty tek Qeveria Qendrore, jemi tek pushteti lokal që bën jetën tonë siç thuhet bukur, që kur nga bebja derisa plakemi e shkojmë në përjetësi, kemi shërbimet, duam shërbimet e pushtetit lokal, këtu të përqendrohemi. Pra, jemi në një komunikim, si ne të gjejmë rrugë dhe mënyra dhe forma për t'ju ndihmuar, po në qoftë se ju jeni kaq bukur, kaq mirë, hajt mos e vendosim gjithë në Klos, po vijmë aty. Mirëpo, dakord, dakord për Zotin Klevisë, ti mandatin tjetër, kandidatin e Klosit, kështu që.

Arbjan Mazniku:

Pra, Klevis. Po, zonja Kola.

Valbona Kola:

Të lutem, unë, jo, ju mirë se vini në Klos, jeni të mirëpritur të gjithë. Biles, po ua bëj thirrje këtu edhe një ftesë që dëgjeshin publike, pse mos ta bëjmë dhe një dëgjim tjetër në Klos me komunitetin e Klosit, do ishte shumë mirë të ishit aty dhe këto do, nëse ju do dilni në territor, do ta shihni se sa investime janë bërë gjatë këtyre viteve në të gjithë territorin e Bashkisë së Klos, pa diskutim, pa, duke i shpërndarë në të gjithë njësitë administrative. Sa për shkollat, e desha dhe këtë, ato shkolla të cilat përmendët ju, në fakt.

Luçiano Boçi:

Më fal, zonja Kola, se më duhet për procedurë, të shënohet kërkesa që ju doni një dëgjim publik, se jemi live, është shumë e rëndësishme kjo. Kështu që, Leandro, mund ta shënojë dhe ne do e bëjmë pjesë të agjendës së Komisionit, jo, po ftesë, ftesë, se për të ardhur do vijmë ne. Këtë ftesë duam ne, kështu që besoj që thjesht e bindur.

Valbona Kola:

Sa për shkollat, të lutem.

Luçiano Boçi:

Do vijmë në Klos, do bëjmë dëgjimin publik në Klos. Faleminderit shumë për këtë gjë.

Valbona Kola:

Gjithashtu, sa për shkollat, desha të ju them që. Ato shkolla, në fakt, janë shkolla anekse, shkollat që përmendët ju dhe të gjithë shkollat e tjera janë me nxënës mjaftueshëm, nuk janë mbyllur shkolla të tjera, ato tre-katër anekse shkollash, ku të gjithë prindërit kanë të drejtën dhe fëmijët t'i çojnë në një shkollë më të mirë për të studiuar, sepse tek e fundit punojmë për të ardhmen e këtyre fëmijëve tanë.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit, zonja Valbona. Zonja Mjeshtri. Përgjigjen dhe pastaj e keni juve, zoti i AI, dhe besoj se pastaj ta mbyllim që t'i japim kovlorët.

Festime Mjeshtri:

Sa për shpopullimin, sa për shpopullimin, jemi në demokraci, lëvizja e popullatës është e lirë, mund të shkojë ku të dojë, mund të vijë nga zonat rurale në qytet, nga qyteti mund të shkojë në fshat, mund të shkojë nga qyteti në Tiranë, jashtë. Ne si Bashki kemi ca indikatorë që si mund t'i mbajmë këta njerëz aty. E para është infrastruktura që kemi, që kemi investuar në të gjitha njësitet, nëpër fshatra, me qëllim që njerëzit të jetojnë në mënyrën më të mirë të mundshme. Kurse për infrastrukturën që është shtylla kryesore që ne kemi, nuk duhet të lëmë pa përmendur rrugën e Arbrit, sepse të vish sot nga Tirana në Bulqis duhet 40 minuta. Para vitit 2014, të vije në Tiranë 4 orë, një natë përpara nxinte makina, pastaj nesër në mëngjes nisesh për Tiranë. Dhe kjo është vërtetë shumë e rëndësishme, sepse unë kam njerëz që punojnë në Bashki, vijnë nga Tirana dhe ikin prapë, më shpejt vijnë në Bulqis sesa shkojnë në Kamëz. Faleminderit.

Luçiano Boçi:

Këtu e vure në pozitë zotin Mazniku, sepse ka qenë nënkryetar i Bashkisë së Tiranës edhe ka përgjegjësi shumë të madhe që shkon më shpejt në Bulqis sesa në Kamëz. Kështu që me kujdes, deklaratat këtu se janë shumë sensitive, janë shumë ndjeshme, duhet të jeni të kujdesshëm. Kështu, buxhet nuk doni ju, me sa shoh unë, se unë bëj pyetje për buxhetin, ju sillni përgjigje.

Arbjan Mazniku:

Kamza nuk është në Tiranë.

Luçiano Boçi:

Jo, jo, po jo, lidhja, lidhja, se e di unë që Kamza është mbetur, se po, s'keni bërë rrugët e duhura.

Altin Bojni:

Atëherë, për sa i përket strategjisë për ripulim, ke, ka fshatra, ka, ka lëvizje, nuk është se nuk ka, nuk ka lëvizje, por ne kërkojmë të bëjmë shërbimin si në shkollë, në rrugë, në ujësjellës, kanale vaditëse, shëndetësi, kopshte, që ato banorë që janë atje ta marrin këtë lloj shërbimi edhe mos lëvizin nga zonat ku ato jetojnë. Kjo është ajo që ne ofrojmë si pjesë e Bashkisë. Për sa i përket edhe të gjithë, e thamë pjesën e rrugës së Arbrit, e vërteta është që për sa i përket Dibër, Bulqis, Klose dhe Matë, me të vërtetë është shumë më afër, është më e aksesueshme edhe është më afër kryeqytetit. Kështu që ajo është diçka që ne e dimë të gjithë, edhe nga Tirana në Matë, në Burrel sot është 50 minuta, që do të thotë është, dikur ka qenë dy orë, sot është 50 minuta, është më e aksesueshme edhe ka dhe më shumë interes edhe për sa i përket qoftë edhe investimeve që bëhen në Bashkinë e Madhe. Për sa i përket transferteve, ato që thamë, të gjithë bashkitë normal që kërkojnë ta kenë transferten më shumë se 1%, unë thashë një mendim që mund të jetë 2 deri në 5%, pastaj është pjesë tjetër se si vendoset. Shumë faleminderit.

Luçiano Boçi:

Atëherë, aksesueshmëria e zonës nuk ka të bëjë vetëm, është një element i lidhjes, vetëm e lidhjen me një qendër tjetër qarku, në këtë rast me Tiranën, aksesueshmëria ka të bëjë me lartësinë nga qendra e Bashkisë me banorin më të largët në njësinë administrative. Për këtë po pyes unë, nuk po them a u lidhët ju me Tiranën dhe sa orë du unë nga Elbasani të vij tek ju. S'është kjo, është pushteti lokal, nuk po flasim për rrugën e Arbrit këtu ne. Pse ngatërroheni të gjithë? Rruga e Arbrit, rruga e Arbrit, e bëtë si historia e Gunës, Guna, Guna. Po më, rruga e Arbrit u bë, mbaroi rruga e Arbrit, i shërben të gjithëve. Shumë mirë që është bërë. Kush po thotë që ne po themi që pse u bë rruga e Arbrit? Ne po themi ju si e keni infrastrukturën brenda Bashkisë suaj, si i arrini qytetarët që janë 3 orë, 4 orë larg, që nuk marrin shërbimet, që duhet të vijmë me paratë e tyre, jo me shërbim urban që duhet ta ofroni ju dhe marrin shërbime në qytet. Kjo është ajo. Pse i shmangni ju këto gjëra? Pse s'i kërkon? Pse s'po ju kërkoj llogari unë? Ju kërkojeni më, i duam, duam investime për malet, dakord me paketa maleve. Vendet e tjera, Zvicra, ka një model që duhet ta kërkon ju për zonat malore, kryesisht ju, ju dhe Kukësi, që ka një paketë në buxhet të dedikuar për rrugët malore, janë me kosto dyfish, trefish se është terren i tillë dhe duhet kërkuar kjo që ju të keni investime dhe të merrni paketa financiare të veçanta për zhvillimin e gjithë territorit. Ju thoni jemi bukur, jemi mirë, shumë mirë. Po rruga e Arbrit, po mirë, e morëm vesh rrugën e Arbrit. Po, faleminderit shumë i qartë nga të gjitha përgjigjet.

Klevis Jahaj:

Tani shumë faleminderit. Në fakt realisht unë nuk kam shumë pyetje, se u zgjeruam, po kam disa komente. Një për afërsinë që ndjej me lidhje me qarkun. Kam pasur fatin që të kem angazhim në atë qark dhe e kam parë nga afër gjithë ndryshimin që ka pësuar zona për shkak të investimeve, mirëmenaxhimit dhe të gjitha me radhë. Dhe besoj që është një nga qarqet aktualisht me potencialin më të madh të zhvillimit, qoftë të turizmit infrastrukturor, por edhe të bujqësisë. Dhe kjo është falë të gjitha projekteve, investimeve, angazhimeve që ka marrë shteti shqiptar, qeveria, patjetër duke gjetur mbështetjen e bashkive për implementimin e të gjithë projekteve që ndodhin aty. Por dua që bashkë me këtë dhe bashkë me komentin që bëri bashkëkryetari, që patjetër më unë do ta kisha për nder të kandidoja në qarkun e Dibrës, pavarësisht se jam shumë i nderuar që përfaqësoj Mallakastrën këtu, sepse ka një ngjashmëri shumë të madhe ndërmjet krahinës së Mallakastrës dhe qarkut pikërisht të Dibrit, të identitetit dhe të dëshirës që kanë ata për përcaktim, për të vazhduar, për t'u zhvilluar. Por realisht dua t'ju kërkoj edhe kryetarëve që mos bini pre pikërisht e këtyre që unë dua të ruaj bashkinë time. S'është ky qëllimi i këtij debati. Është pikërisht ajo që ne flasim, që kush mund të jenë kompetenca të tjera të, një minutë, po folim, një kompetencë të tjera për decentralizimin e këtyre. Dhe ky qark e ka shembullin dhe Bashkia e Klosit, e cila nuk ka qenë bashki më përpara, është bërë bashki me reformën, po mirë, mirë, po një minutë, bashkë me reformën territoriale ka pasur dhe kompetenca të tjera në lidhje me këtë. Nuk do të thotë që heqja e komunave humbi ndonjë identitet, për shembull Maqellara është prapë më e fortë, pavarësisht se është një njësi administrative e Dibrës. Pra, nuk do të thotë dhe nuk mund të bien pre e diskutimeve që në qoftë se ndryshojnë kompetenca të caktuara administrative, humbasin

identitetin. Edhe për mua nuk duhet të ndryshojë ndonjë bashki, në qarkun e Dibrës, jua them edhe unë opinionin tim, por patjetër ajo që duhet të priremi ne, siç është shembulli i ujësjellësit, kush janë mekanizmat të tjerë që mund të shërbejnë për menaxhimin më të mirë dhe mund t'i vijë në ndihmë qarkut ose rajonit në lidhje me këtë. Kush janë ato kompetenca të cilat funksionojnë që ju e keni të vështirë me fondet aktuale që ju janë deleguar ju dhe nuk mund të shërbehen ashtu siç duhet. Kush janë ato shërbime që patjetër, siç mund të jetë shembulli i menaxhimit të integruar të mbetjeve, mund të kenë një zgjidhje më të mirë duke u bashkuar dhe duke ndërvepruar më mirë bashkitë e një qarku. Pikërisht kjo është ajo që diskutojmë me njëri-tjetrin dhe unë mendoj, dhe një nga pyetjet që po them, a mendoni ju që njësitë administrative ose zonat tjera duhet të kenë më shumë kompetenca të cilat duhen deleguar nga ju për t'u shërbyer më shumë qytetarëve? A ka njësi administrative tani ndonjë shërbim ose bashkia juaj që nuk e jep dot dhe e ka dhënë më përpara komuna? Kanë ndodhur forma të tilla? Jo. Unë në të gjithë dëgjimet që kemi pasur dhe me kryetarët e tjerë të bashkisë, nuk ka pasur asnjë shërbim që i ka munguar. Përkundrazi, janë shtuar shërbimet të cilat japin bashkitë dhe njësitë administrative. Dhe realisht qarku i Dibrës, me planet e investimeve dhe me aftësinë që ka bashkia, bashkitë e qarkut, Dibra, Mati, Klosi dhe Bulqiza për implementimin e tyre, se është shumë e rëndësishme që të gjenden dhe kapacitetet për implementimin e investimeve strategjike që çon qeveria, ka marrë një nga zhvillimet më të mëdha për mua në të gjitha qarqet e tjera. Dhe Klosi është vetëm 20 minuta nga Tirana. Pse është në një çudi që mund të regjistrohet dhe në Tiranë të banojnë Klosë, ose një nga Tiranat të banojë aty dhe të vejë në punë? Nuk ka asnjë çudi këtu. Shërbimet e marrin në Bashkinë e Klosit, si e marrin në çdo lloj bashkie tjetër. Dhe për mua, nga afërsia, është një lagje e Tiranës, pavarësisht se është një bashki dhe një qark më vete. Dhe nuk kanë ikur njerëzit se mungon shërbimi i infrastrukturës. Në Suç e kudo tjetër aty, në Dzibër edhe kudo tjetër, janë më afër se kurrë kundrejt shërbimit dhe mund ta marrin atë kudo. Shërbimet që më përpara ju duheshin ditë për të shkuar kudo dhe në Tiranë dhe në çdo qendër tjetër të bashkive ose institucioneve tjera qendrore. Dhe kjo duhet thënë dhe kjo nuk duhet t'ju vërë ju në vështirësi që pse t'i themi ne. Se çfarë sjell të mirë dhe ndarje administrative e tillë dhe investime të integruara për zhvillimin e qarqeve. Dhe për ta përmbyllur pak këtë, me gjithë dëshirën e madhe që kam dhe dashamirësinë për gjithë qarkun, me thënë të drejtën, kam vetëm një pyetje e gjysmë. Si mendoni është më mirë, ky reformë, ky komision, reforma e re duhet të bazohet në ndarjet territoriale apo në rritjen e kompetencave dhe mbështetjen për ndarjet aktuale dhe të kompetencave që ka pushteti lokal aktualisht ose njësi të tjera administrative nën bashkinë ose qarkun që ju mbuloni? Faleminderit.

Arbjan Mazniku:

Zonja, lutem.

Denisa Vata:

Atëherë, përshëndetje të gjithëve. Këtu diskutuan në fakt disa gjëra në disa drejtime, ku më së shumti u përmendën edhe investimet në bashkitë e qarkut Dibër, por unë në fakt

kam disa pyetje. Duke qenë se reforma territoriale, ideja e kësaj është si një reformë që do të krijonte bashki më të forta dhe më me shumë specialistë dhe më shumë kapacitete teknike dhe më shumë mundësi për të planifikuar e zbatuar investime cilësore, dua t'i drejtohem me një pyetje zotit Bojni, duke ju referuar kësaj që sapo thashë. Në këtë kuadër, unë, zoti Bojni, kam një shkresë të ardhur nga RSH për investimin 1.2 milion euro, siç është Unaza e Burrelit, tashmë totalisht e shembur. Dhe duke qenë se reforma ka, e thashë dhe njëherë, prioritet specialistë më të mirë, kapacitete teknike më të mira, si ka mundësi që një bashki e madhe me më shumë staf sesa komunat e mëparshme që ose ish-bashkitë e vjetra, me më shumë buxhet, nuk arriti të evidentojë një problem kaq elementar teknik duke vënë në rrezik një investim 1.2 milion euro? E njëjta pyetje, zoti Bojni, duke ju referuar kësaj, kam edhe për sheshin e qytetit, sheshi Ahmet Zogu apo sheshi Demokracia, sepse i është ndërruar emri disa herë. Duke qenë se i gjithë sheshi është bllokuar dhe qytetarët, sidomos banorët e qendrës, e kanë shumë të vështirë të shkojnë në shtëpitë e tyre me makinë dhe duhet të parkojnë disa kilometra larg shtëpisë, dhe qendra është totalisht e paaksesueshme. Dhe duke qenë se e ritheksoj dhe njëherë, reforma territoriale i mshon shumë specialistit më të mirë, teknikut më të mirë, urbanistit më të mirë. A keni bërë ju një studim, Bashkia e Matit, sepse RSH, më fal, Fondi Shqiptar i Zhvillimit thotë në një shkresë që Bashkia e Mat ka pasur të, Bashkia e Mat i ka paraqitur projektin për financim Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Pra, si është e mundur që të bllokohej qendra për qytetarët e Burrelit të, po jo vetëm Burrelit, por dhe për njësi administrative? Kjo vlen.

Altin Bojni:

Për sa i përket pyetjes, se po e nis nga pyetja e dytë sheshit, aty është akoma një kantier ndërtimi. Është një investim i Fondit të Zhvillimit.

Denisa Vata:

Duhet të kishte përfunduar sipas.

Altin Bojni:

Është investim i Fondit të Zhvillimit edhe akoma nuk është bërë. Tani a mund t'i përgjigjem? Sheshi është kantier ndërtimi, akoma nuk është marrë as në dorëzim, edhe është një investim i qeverisë dhe nëpërmjet Fondit të Zhvillimit. Momenti që do merret në dorëzim pjesa e sheshit, pastaj ne do bëjmë dhe pjesën e menaxhimit të tij. Për sa i përket, janë të dy pyetjet që, për sa i përket dy pyetjeve, edhe ajo pyetja tjetër, pyetja e parë që është për pjesën e RSH-së, është e vërtetë. Është 1.2 milion, është investimi në Unazën e qytetit të Burrelit, edhe ky është një investim i RSH-së. Edhe për sa i përket të gjithë atyre që është, nuk është bërë pyetje vetëm këtu, por është bërë dhe pyetje me shkresë. Besoj se e keni marrë dhe përgjigjen edhe nëpërmjet shkresave që është, që është, që jemi përgjigjur. Faleminderit.

Denisa Vata:

Më fal, zoti Bojni, unë pyetjet i kisha për juve. Unë nuk ju kërkova të bëni zëdhënës i RSH-së apo i Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Pyetja ishte shumë e qartë, sepse lidhet edhe me reformën territoriale, lidhet me specialistë më të mirë, lidhet me teknikë më të mirë, lidhet me menaxhim më të mirë të fondeve publike. Pra, kjo ishte pyetja. Unë nuk po ju kërkoi llogari juve, se ju as keni qenë as kryetar bashkie kur është bërë Unaza, as kur është bërë sheshi i qytetit. Pra, nuk po ju vëmë juve para përgjegjësisë. Por duke u nisur nga kjo, nga këndvështrimi juaj si kryetar bashkie, si e konsideroni, unë nuk po ju kërkoi të më shpjegoni shkresat e RSH-së juve. Si e konsideroni që nuk mund të menaxhohet një investim kaq serioz? Pra, për shkak se vetë në shkresën që RSH-ja më ka sjellë thotë kontrata asistim asfaltim Unaza e Burrelit, projekti nga Bashkia e Mat nuk ka pasur të evidentuar rrëshqitje dhe për rrjedhojë nuk ka pasur masa inxhinierike për trajtimin e tyre. Pra, a ka specialistë bashkia? Se ju i kërkoni, i drejtoni këtu, i drejtoni disa pyetje zonjës Kola, shumë tendencioze, për të thënë që ju gjasme nuk keni specialistë edhe ju duhet të bashkoheni me Bashkinë e Matit. Më fal, ta mbaroj. Pra, dhe ju vetë në një projekt kaq serioz siç është Unaza e Burrelit, kjo tregon qartë nga shkresa se, sepse në Unazën e Burrelit, zoti, në Unazën e Burrelit, zoti Bojni, ka dhe vendime të këshillit bashkiak që janë dëmshpërblyer. Disa herë familjet aty janë dëmshpërblyer, për shembull, janë dëmshpërblyer. Pra, dhe unë tani nuk po të kërkoi ty se pse u shemb Unaza, se e thashë dhe njëherë, ti s'ke qenë as kryetar bashkie, por çështja është në këndvështrimin e kësaj reforme për teknikë më të mirë, për specialistë më të mirë, për investime më të mira, më të menaxhueshme.

Altin Bojni:

Përse, për sa i përket dhe pyetjes që bë zonja deputete, më duket se jemi pak edhe jashtë teme. Mendoj se jemi jashtë teme fare. Kjo. Në rregull. Unë them ta mbërrij edhe unë pjesën time, se unë do dëgjoja deri në fund. Edhe pjesa e projekteve, qoftë të RSH-së apo qoftë edhe të pjesës së, qoftë të Unazës apo të, qoftë janë projekte që bëhen në studio private dhe janë projekte që nuk janë. Për sa i përket për çdo informacion tjetër, mund ta drejtojnë me shkrim dhe mund t'i kthejnë përgjigje. Shumë faleminderit. Atëherë, të bëj dhe unë.

Denisa Vata:

Jo, kam dhe një pyetje tjetër. Jo pyetje, në fakt më shumë.

Unë e mbështes kërkesën e zonjës Kola, kryetares së bashkisë së Klosit, për të bërë një dëgjim publik në bashkinë e Klosit. Besoj se qytetarët e Klosit u pa qartë që edhe në takimin që bëmë, dëgjimin që bëmë në qarkun Dibër, pothuajse të gjithë ishin të të njëjtit mendim që bashkia Klos nuk duhet të bashkohet me bashkinë e Matit dhe e konsideroj shumë serioze kërkesën e kryetares së bashkisë. Dhe ne jemi të gatshëm të thirrjmë të gjithë qytetarët të dëgjojnë banorët e Klosit, sepse për mendimin tim të parët janë banorët që duhet të dëgjohen, qoftë jo vetëm për këtë që është shumë serioze, por edhe për parqet fotovoltaike që po bëhen në bashkinë e Bulqizës, por edhe për ecjen e Kurdarisë dhe në të gjitha drejtimet dhe investimet që ndërmerren nga kjo qeveri ose nga bashkia

ose nga privati. Pra, jemi në mbështetje të zonjës Kola për sa i përket dëgjimit dhe me zor presim të dëgjojmë banorët e Klosit a janë pro apo ndarjes së bashkive.

Arbjan Mazniku:

Atëherë, faleminderit. Po, lutem.

Alma Selami:

Përshëndetje të katër kryetarëve të bashkive dhe shumë faleminderit për prezantimet. Një përshëndetje për të gjithë kolegët, dy bashkëkryetarët. Në fakt, ishte një dëgjim. Unë vij për herë të parë në këtë komision, por ishte ndër dëgjimet me shumë mbresa, në fakt, edhe nga mënyra e qytetëruar e të gjithë drejtimit, moderimit, por edhe të pyetjeve. Do t'ju, në fakt, nuk do të bëja pyetje për shkak se besoj që pjesa më e madhe e tyre u ezauruan. Ajo çka më bëri që të mund ta marr tani fjalën është në mënyrë me shumë kërshtëri, në fakt, bashkëkryetari u drejtua entuziazmit tonë dhe këtu, në mënyrë vërtetë shumë të sinqertë, do të desha të dija nëse më herët kryetari e kishte bërë rrugën e Dibrës, por edhe të skajit më të largët të saj, të Lurës, ku sot bëhet nga qendra e Tiranës për më pak sesa tre orë e gjitha, ndërkohë që flitej për një tetë orësh më herët. Dhe shumë sinqerisht, pjesa Peshkopi-Lurë bëhej vetëm në këmbë, në pjesën më të madhe, sepse nuk ishte aksesueshme shumë nga makinat të lehta, le të themi. Ajo çka unë do të vërej dhe do ta ndiej për entuziazmin sërish bashkëkryetarin është fakti që vërtetë Dibra është qark që pati investime dhe në kuadër të asaj që ju përmendët, cila është strategjia e këtyre katër bashkive për të mundur të nxitur popullin në ato zona që pa diskutim janë larguar për një jetë më të mirë, për shërbime më të mira dhe shlyqyr që ia arritëm dhe ditën që të mund të ketë lëvizje të lirë. Unë që Dibra nga të katër kryetarët doli që është kantier ndërtimi, kjo është vëmendje dhe është në të mirë të të gjithë qytetarëve dhe falë Zotit, lavdi Zotit që erdhi kjo kohë në 35 vjet që ta shohë dhe Dibra këtë investim. Tani ndoshta dhe mund të qeshim, të nënqeshim në gjëra që ndoshta janë bazike dhe thuhet: "Po mirë, po këto gjërat bazike që nisin në fakt me rrugën, infrastrukturë që është aortë e gjenerimit dhe e zhvillimit ekonomik në qarkun tonë, specifikisht është atraksion turistik shumë i lartë, është zhvillim ekonomik i atij vendi dhe shihet në numra dhe në interes të investimeve, në fakt, në zonë." Në ato numra dhe shifra që shtohen për ditë, qofshin në banesat vjetra në zonat dhe kullat tona më të largta, deri dhe në këto qendrat urbane ku kryetarët përmendën se si po shtohet numri i pallateve në ndërtim e tjerë. Kjo nuk mund të merret dhe kaq sipas meje gjithmonë. Nuk mund të merret edhe kaq klishe për të thënë: "Mjaftoheni me kaq." Natyrisht që bashkitë kanë nevojë për transfertë më të mëdha dhe pse jo, kush nuk do t'i donte nga kryetarët e bashkive, po nga të gjithë ne, që njerëzve t'ju shkojë shumë më shumë investim. Por pa diskutim, nëse shikohet kjo reformë në 2015 dhe pas, pa diskutim duhet parë çfarë të mira solli dhe unë besoj që një pjesë e mirë e kryetarëve i përmendën dhe pa diskutim dhe sfidat që ka, që është ndoshta, prandaj dhe janë këto dëgjime që të mund të adresohen dhe të shikohen për t'u përmirësuar. Kështu që shumë faleminderit edhe njëherë për pjesëmarrjen.

Luçiano Boçi:

Një ndërhyrje të vogël, zonja Selami. Faleminderit që mu adresove mua, por në dijeninë time dhe të komisionit është që dëgjimin e kemi me kryetarët e bashkive, jo me bashkëkryetarët e komisionit. Momentin që do vendosim një mbledhje të këtillë, ndoshta e votojmë një ditë ne dhe e vendosim. Unë jam i gatshëm që të ulem aty dhe të jap llogari për gjërat që duhet të jap llogari dhe e mirëpres një gjë të tillë. Ndërsa entuziazmin nuk e godita, e lartësova. Mua më pëlqen gjuha emfatike, se është shumë figurative dhe unë jam pak i fushës këtu edhe e pasuroj atë dijen time në këtë aspekt, sa herë që dëgjoj gjëra të tilla. Më pëlqen, të them të drejtën, e shijoj dhe në këtë aspekt ju drejtova. Nuk kam asgjë, domethënë, negativiste në këtë pikë. Ajo që më shqetëson mua është mënyra si menaxhohet bashkia, domethënë çfarë rrjeti rrugor ka, sa arrin qytetari të aksesojë qendrën, si ofrohen shërbimet, sa përfaqësohet. Është pjesë e diskutimeve rruga e Arbit. Hajde fusim edhe Llogaran, po deshe, edhe tunelin e Llogaras, e fusim këtu, e bëjmë pjesë të debatit. Si doni ju, edhe rrugën Tiranë-Elbasan, e bëjmë pjesë të debatit, se çuditërisht ato të Elbasanit nuk na e përmendin në këtë gjë të madhe. Shumë e madhe është. Dakord, mos të bëhemi selektivë. Po përmendim dhe atë, por ama mos harrojmë në fund fare, jemi për pushtetin lokal, për kërkesat, shqetësimet, problematikat që ai ka, që ne duhet t'i marrim, t'i adresojmë në konkludimet e reformës zgjedhore. Dhe frika ime gjithmonë ka qenë që kur dëgjoj kryetarët, po them edhe shprehjen e famshme se është konsumuar shumë, unë kam frikë se ky komisioni jonë është i tepërt në këndvështrimin tuaj, që ju të gjithë jeni në kontekstin: "Pse duhet një reformë? Ne jemi kaq mirë, kaq bukur, kaq të lumtur." Atëherë do të jetë ndonjë komplot që e ka bërë opozita, që i ka mbushur mendjen kryeministrit që të ngrejë një komision. Po mos e parashtroni kështu, ju lutem. Ju lutem, se nuk shkon. Ka shumë probleme. Janë bërë gjëra, nuk e vë në dyshim nëse kryetari prandaj zgjidhet që të angazhohet me ato burime që ka. Ai ka të mjaftueshme. Këtu është çështja. A mundet që të plotësojë rolin e tij? Jo, se i ka duart e lidhura. Në kompetenca ia merr qeveria, s'ka financa, ka largësi, e ka larg qytetarin. Ne të gjitha këto i duam që t'i pasqyrojmë. Kjo është kryesore. Ky është misioni ynë dhe ky është, kjo është arsyeja për të cilën është ngritur ky komision. Faleminderit, në qoftë se.

Arbjan Mazniku:

Po, kam dhe unë dy gjëra, zoti kryetar, për ta mbyllur. Së pari, dua t'i falënderoj secilit për komentet dhe gjithë kohën. Mendoj që është e udhës që dy-tre mite, të cilat janë ndërtuar në mënyrë sistematike, t'i themi dy-tre numra që i qëndrojnë një sërë realitetesh. Së pari, është një mit i cili ndërtohet në mënyrë sistematike në raport me ndryshimet e popullsisë dhe i cili lidhet me reformën apo tentohet të lidhet me reformën apo tentohet të lidhet dhe me funksionin e bashkive. Në fakt, numrat na tregojnë një gjë që s'është realitet. Shqipëria, si shumë vende të Evropës Lindore, pas hapjes me Perëndimin ka pasur një rënie të popullsisë nga emigracioni, pa dyshim, por kjo është një rënie e cila është sistematike në kohë. Në censusin e 2001-shit, të dhënat tregonin që ne kishim rreth 3.1 milionë banorë, pak a shumë. Në censusin e 2011-shit, pas 10 vjetësh, ishin 2.8 milionë banorë. Do të thotë kishim rënie prej rreth 300 mijë banorësh nga një census një tjetër dhe është një numër i ngjashëm nga 2.8 në 2.4, rreth 400 mijë banorë, të cilët kanë qenë në rënie të popullsisë në 10-vjeçarin tjetër. Pra, rënia e popullsisë nga '89-ta e më pas ka qenë sistematike në çdo census, pak a shumë në të njëjtin numër. Në qarkun specifik të

Dibrës, për të cilin po flitet, për më shumë është edhe më interesante e dhëna, sepse të dhënat na tregojnë që nga viti 2001, nga '89-ta në 2001-shin, censusin e parë ka rënë 16% popullsia. Nga viti 2001 në 2011-tën ka rënë 27.8% popullsia, ndërkohë që nga 2011-ta në 2003-in ka rënë me 21%. Pra, nëse do të thonim për çështjen e rënies së popullsisë, ka një avashësim të rënies së popullsisë në qark, krahasim me 10-vjeçarin e mëparshëm. Thelbi i këtij realiteti është që nuk ka një lidhje midis funksioneve vendore dhe lëvizjes së popullsisë. Lëvizja e popullsisë është një trend global, i cili ka ndodhur dhe vëjon të ndodhi si në nivel migrator, si në nivelin migrator, dhe në një pjesë të madhe të vendeve të Evropës. Ka ndodhur në Irlandë, ka ndodhur në numra shumë të mëdhenj, ka ndodhur në Kroaci, vazhdon të ndodhi, ka ndodhur në Poloni, ka ndodhur në Rumani, në të gjithë vendet e lindore. Thuhet një numër për Evropën. Së pari, është teknikisht i pavërtetë. Evropa, në numrin e popullsisë së saj, ka rënie në 10 vitet e fundit. Ka një rritje e cila vjen nga emigracioni. Pra, numri i popullsisë së vetë Evropës ka një rënie, rreth 2%, në 10 vitet e fundit. Ka një rritje që vjen nga emigracioni. Pra, është kompensuar me njerëz të ardhur nga jashtë, jo Evropa në vetvete. Për sa i përket të ardhurave, që është pika e dytë që besoj që është e rëndësishme, unë besoj që është e rëndësishme që të themi dy-tre të dhëna që kanë të bëjnë me mënyrën si funksionon tani dhe një debat i cili duhet bërë. Raporti midis të ardhurave të vetave të bashkive dhe atyre që i vijnë nga granti. Përmendet rregullisht këtu një element i transferit të skurzuar dhe elementëve të ekualizimit. Formula jonë ekzistuese e grantit ka një element ekualizues. Mund të shihet nëse ai mund të përmirësohet si element ekualizues, pa dyshim, dhe është një debat që duhet bërë. Dy nga argumentet e ngritura këtu që kanë të bëjnë me mënyrën se si ndahet granti, që kanë të bëjnë me elementët e distancës, e sipërfaqes, elementë që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike të territorit, do bënin shumë sens që të diskutoheshin eventualisht në formulë. Por ama të dhënat na tregojnë që fjala që bie, bashkia Dibër, mbledh, bashkitë mesatarisht mbledhin rreth 9,800 lekë për frymë në Shqipëri, të gjitha bashkitë. Dibra mbledh 2,721 lekë ose rreth 82% më pak se mesatarja kombëtare, ndërkohë që merr nga granti 9,523 lekë, rreth 1% më shumë sesa ç'është mesatarja kombëtare e grantit. Mati mbledh 6,463 lekë për frymë, rreth 57% më pak se mesatarja kombëtare. Po merr, mbledh më shumë sesa Dibra, po pak më pak se mesatarja kombëtare, ndërkohë që merr nga granti 15,373 lekë për frymë ose 64% më shumë se mesatarja kombëtare. Pra, ka një element të ekualizimit të qëndrueshëm. Klosi merr, mbledh 3,000 lekë, 3,044 lekë nga të ardhurat e veta dhe merr nga granti 10,723 lekë ose 14% më shumë se mesatarja kombëtare. Bulqiza mbledh 3,131 lekë, 79% më pak se mesatarja kombëtare dhe merr nga granti 17,000 lekë për frymë ose 81% më shumë se mesatarja kombëtare. Pra, ka një element ekualizimi. A duhet të tarrohet, a duhet të sistemohet më mirë ky element? Pa dyshim që është një debat që duhet bërë. Dhe numri i fundit që besoj që bën sens për këtë, sepse është një ndër elementet që ngrihet në mënyrë sistematike, pjesërisht me të padrejtë, është elementi i çështjes së stafeve të bashkive. Tani, po, ka qenë një ndër objektivat e reformës së 2014-s ulja e stafeve të bashkive për sa i përket pjesës së stafeve administrative. Atyre stafeve që janë juristët, financierët, ekonomistët, këshilltarët, njerëzit që kanë funksione administrative. Por pa dyshim që dhe kjo në fakt është ulur. Pra, bashkia Dibër në strukturën e aparatit ka sot 324 veta. Ka pasur bashkitë që përbëjnë, njësitë administrative që përbëjnë bashkinë Dibër, kanë pasur 387, ka një ulje prej 16%

të stafit në këtë strukturë. Po patjetër ka një rritje të stafit që ofron shërbime, njerëzit që plus funksionet e reja, por aparati është ai që është ulur. Në Bulqizë ka qenë, ka shkuar nga 192 në 93, është ulur me 51%. Në Klos nga 96 në 92, është ulur me 5% dhe në Mat nga 173 në 112, është ulur me 35%. Pra, stafet që ishin ata që bënë funksionet e aparateve janë ulur më ndjeshëm, por janë rritur stafet e funksioneve të reja si zjarrfikëset, mirëmbajtja e pyjeve, mirëmbajtja e kanaleve të rrjedhës së ujit të vadicës, mirëmbajtja e shkollave që ishin funksione të reja që bashkitë morën, por edhe stafet e shërbimeve, si në rastin e Matit që e përmendi, që një funksion që e ka pasur të kontraktuar e ka marrë vetë, që është pastrimi. I them këto për të sqaruar opinionin publik që na ndjek, që ka disa argumente që ngrihen, por që në fakt numrat na tregojnë një realitet të ndryshëm nga ky dhe besoj që fokusi tek përmirësimi i funksioneve dhe tek financat, dhe duke diskutuar pa dyshim elementin e territorit si një element i cili është në subjekt të ofrimit të shërbimit më të mirë ndaj qytetarëve, është përqsasja e duhur për të pasur bashki më të forta dhe më të qëndrueshme. Faleminderit shumë kryetarëve dhe do, nëse s'ka diçka për të shtuar kryetari, do ja ta mbyllim që.

Luçiano Boçi:

Tani, ajo që vërej unë që duke punuar komisioni, kemi dalë edhe në një teori numrash. Kemi dy lloje teorie numrash. Kur numrat atakojnë popullsinë, nuk kanë sens. Numri nuk ka sens sipas logjikës së parashtruar. Edhe kur flitet për rritjen e administratës në total, në raport me atë çka ishte, që është dyfishuar nga 19,000 në 40,000, prapë ky numër nuk ka sens se hyn ai numër i vogël i stafit të administratës. Ka dhe ca numra pastaj që paskën kuptim kur flitet për të ardhurat, kur flitet mesatarizimi. Numri o ka vlerë, o s'ka vlerë dhe o ka sens, o nuk ka sens. Ka dy teori numrash, mos i keqpërdorim se po i nxjerrim edhe djersën numrave të ky lloj komisioni. Shpopullimi në Shqipëri është fakt real dhe është alarmant. I thënë jo vetëm nga statistikat shqiptare, nga statistikat europiane. Dhe ne humbasim popullsi për shkak të emigrimit, jo migrimit. Migrimi është trend. Mos ngatërroni trendin me fatkeqësinë. Emigrimi është fatkeqësi për një komb, se humbet pasurinë më të madhe, humbet burimin njerëzor që Shqipëria ka pasur dhe sot nuk e ka. Dhe nuk kemi bërë debatin që Europa është rritur natyralisht. Jo, edhe Europa ka trende nataliteti tulta. Shqipëria, për herë të parë këtë vit, është negative në të gjithë qarqet e saj dhe këtu krahasohet dhe është baraz me Europën. Dhe nuk kemi thënë ne që Europa është rritur natyralisht. Ne po ballafaqojmë faktet tona. Është rritur nga ne, Europa. Është pranuar, u pranua dhe këtu. Po, nga emigracioni është rritur, nga emigracioni i shqiptarëve, nga ikja e shqiptarëve. A në qoftë se do të ishte migracion, patjetër që do të jetë trend. Unë e thashë argumentin tim shumë të qartë, që Tirana ka shtuar 15,000, Shqipëria ka humbur qindra mijë dhe ka nikur jashtë këto. Më shumë ka humbur Dibra se ka fituar Tirana. Dhe këto janë realitete dhe t'i mohojmë këto ne dhe të themi që nuk është shkak pastaj pushteti vendor, shërbimi i keqytetari për të ikur qytetari, nuk është shkak. Po si mos je ka shkak? Kur i mbyllet shkolla, kur i ikën shëndetësia, kur s'ka siguri, kur i japin një lëmshë ndihmë ekonomike 30,000 që ai të hajë vetëm bukë, si mos do rrijë aty? Ai nuk i jepet ndihmë për zhvillimin ekonomik, nuk i jepet asnjë lloj asistence sociale. Çfarë do bëjë ai? Do rrijë aty mes natyrës, të shijojë vetëm ajrin e pastër dhe gjelbërimin? Jo, mos do ikje ai se do rrisë fëmijën, kërkon siguri, kërkon jetë më të mirë dhe këto janë arsye bazike dhe të

qëndrueshme për të ikur. Dhe këtë shtimin tjetër të stafeve, se e kemi debatuar dhe unë çuditem si e rimarrim me një lloj gjakftohtësie që është për t'u pasur zili. Këtë punën e stafeve, kur u bënë funksione në 2014-ën, janë parashikuar më të gjitha dhe funksionet dhe kompetencat dhe financat. Përndryshe, pse e quani ju reformë të lavdishme kaq të madhe? Janë parashikuar aty. Se ishte kjo reformë që tha do shkurtohet, nuk e thamë ne nga dëshira. Ishte reforma që tha do ulet administrata dhe 80 milion euro do shkojnë për investime, ndërkohë që sot është e kundërta, është dyfishuar. Jo, po është staf për këtë funksion, po janë parashikuar. Pra, i kishte aty 42 funksione me kompetenca edhe sipas tyre, me ato financa që janë, që duhen më shumë, po që duhen më shumë. Në qoftë se ne nuk pranojmë këto realitete, se s'jemi këtu për të paraqitur sukseset, jemi për të marrë problemet, atëherë nuk ka sens më që ky komision pastaj të harxhojë kaq energji, të harxhojë dhe financa ky komision, për të arritur në konkludimin që jemi shumë mirë se jemi keq, po ka dhe më keq. Kështu që të ruajmë këtë që është keq. Kjo s'është e logjikshme. Gjithsesi, unë falenderoj kryetarët e bashkive që vlerësuan këtë dëgjës, që erdhën dhe ishin prezent, dhanë mendimet e tyre, shprehën shqetësimet e tyre, por pa shmangshme dhe lëvdatat e tyre. Shumë faleminderit dhe suksese në punën tuaj.

Arbjan Mazniku:

Faleminderit. Atëherë.